



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 436 Akti

Nr. 534 Vendimi
Tiranë më 23.05.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Etleda Çiftja	Kryesuese
Roland Ilia	Relator
Pamela Qirko	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Amela Idrizi, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, në datën 5.4.2022, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Elveta Stafa (Murra)**, me detyrë prokurore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionerin Roland Ilia, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Elveta Stafa (Murra), e cila në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

- 1.** Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5, të nenit 179/b, të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1, të nenit 5, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
- 2.** Subjekti i rivlerësimit Elveta Stafa (Murra), me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, është subjekt i rivlerësimit që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio* në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
- 3.** Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në muajin dhjetor të vitit 2019, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit Elveta Stafa (Murra) do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 1, i përbërë nga komisionerët Pamela Qirko, Roland Ilia dhe Etleda Çiftja.
- 4.** Për këtë subjekt rivlerësimi u caktua me mirëkuptim kryesuese e trupit gjykues, komisionere Etleda Çiftja, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Elveta Stafa (Murra).
- 5.** Në referim të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit Elveta Stafa (Murra) nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.
- 6.** Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016 dhe, veçanërisht, në nenin 30 të këtij ligji kishte për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.
- 7.** Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë i prokurorisë (në vijim KLP). Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.
- 8.** Në përputhje me nenet 30-33 të ligjit nr. 84/2016 u administrua akti i kontrollit me nr. *** prot., datë 24.6. 2019, të ILDKPKI-së, protokolluar pranë Komisionit me nr. *** prot., datë 3.7.2019, ku është kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit Elveta Stafa (Murra), me detyrë prokurore pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

9. Në vijim, relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm.

10. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara vetëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë në datën 17.3.2022, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për një nga tri kriteret për subjektin e rivlerësimit; (ii) njoftimin e subjektit për t'u njohur me materialet e dosjes; si dhe (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, për kriterin e pasurisë, mbështetur në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

11. Subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi të drejtën e saj për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti, pasi u njoh me aktet e dosjes, ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave mbështetëse mbi rezultatet e hetimit deri në datën 31.3.2022.

12. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim shpjegimet e paraqitura dhe provat e sjella nga subjekti i rivlerësimit dhe përfaqësuesi ligjor i saj, vendosi të ftojë znj. Elveta Stafa (Murra), në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

II SEANCA DËGJIMORE

13. Subjekti i rivlerësimit Elveta Stafa (Murra), u ftua në seancën dëgjimore të datës 5.4.2022, ora 10:00, me njoftimin e bërë elektronikisht me *e-mail*, në datën 30.3.2022. Në ditën dhe orën e seancës dëgjimore subjekti i rivlerësimit kishte dërguar përfaqësues ligjor me prokurë, z.K.M, i pajisur me nr. *** licence dhe NIPT ***, avokat pranë Dhomës së Avokatisë Elbasan, me prokurë të posaçme me nr. *** , datë 4.4.2022. Përfaqësuesi ligjor kërkoi shtyrjen e seancës dëgjimore për t'u njohur me materialet e çështjes, kryesisht ato të hetimit administrativ të kryer nga Komisioni i Pavarur të Kualifikimit. Trupi gjykues, pas tërheqjes në dhomë këshillimi, doli me vendimin, ku caktoi seancën dëgjimore të radhës në datën 22.4.2022, ora 10:00, në të njëjtin vend.

14. Në seancën dëgjimore të datës 22.4.2022, ora 10:00, përsëri subjekti i rivlerësimit nuk ishte prezent, por nëpërmjet avokatit të saj (i cili kishte dërguar njoftim), kërkoi shtyrjen e seancës dëgjimore të datës 22.4.2022, ora 10:00, për shkak se ishte në gjendje shëndetësore jo të mirë (bashkëlidhur njoftimit përfaqësuesi ligjor ka sjellë raportin mjeko-ligjor nr. *** regj., datë 21.4.2022). Trupi gjykues, pasi shqyrtoi kërkesën e përfaqësuesit të subjektit të rivlerësimit, vendosi pranimin e kërkesës së përfaqësuesit të subjektit dhe caktoi seancën dëgjimore në datën 28.4.2022, ora 10:00, në të njëjtin vend.

15. Edhe seanca e datës 28.4.2022 nuk u zhvillua për shkak të kërkesës së subjektit të rivlerësimit për të shtyrë seancën dëgjimore sepse, *sipas vërtetimit datë 28.4.2022 rezulton "pozitiv", me COVID 19 dhe ky fakt pamundëson objektivisht paraqitjen në seancën e sotme.*

16. Trupi gjykues, pasi administroi dokumentet që solli subjekti, nëpërmjet përfaqësuesit të saj në lidhje me gjendjen shëndetësore të saj dhe të avokatit të saj (*kërkesa nr. *** , datë 28.4.2022, e z. U.B (porositës nga av .K.M); njoftimi i avokatit K. M, datë 28.4.2022; vërtetim nr. *** prot., datë 28.4.2022 nga Nj.V.K. Shëndetsor Elbasan; kartelë ditore nga Qendra Spitalore "Dr. Xh.K ", nr. *** arkive, datë 28.4.2022 dhe grafi pulmonare të z. K.M*), si dhe shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit, vendosi që seanca dëgjimore e radhës do të mbahet në datën 19.5.2022, ora 10:00, në të njëjtin vend.

17. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", në datën 19.5.2022, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla Ovale, kati I, Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar.

18. Subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet përfaqësuesit të saj ligjor, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe për të parashtruar shpjegimet, provat dhe opinionet e saj, në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj dhe në përfundim kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

19. Znj. Elveta Stafa (Murra) në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, gjatë procedurës së hetimit administrativ, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” është përgjigjur në kohë, por disa herë veprimet e saj duket se janë bërë shkak për zgjatjen e procesit të rivlerësimit.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

20. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

21. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

21.1 Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

21.2 Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

21.3 Ndërsa, sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016 parashikohet objekti i rivlerësimit të aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

22. Referuar vendimit nr. 2/2017^[1] të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1 Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

21. ILDKPKI-ja ka kryer procedurat e kontrollit për vlerësimin e pasurisë referuar neneve 30-33, të ligjit nr. 84/2016 dhe ka dërguar raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit Elveta Stafa (Murra) dhe në përfundim nga ky institucion, është konstatuar se:

^[1] “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: ‘Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit’. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: ‘Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelimit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë’. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

- deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar burimin e krijimit të pasurisë;
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

21.1 Znj. Elveta Stafa (Murra) është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003 me numër indeksi *** dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar dhe të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, ka dorëzuar, ndër vite, deklaratat e interesave private:

- para fillimit të detyrës në vitin 2003;
- periodike vjetore për vitet 2004 – 2017; si dhe
- deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar, *Vetting*.

A/II Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

22. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, *Vetting*”;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar, *Vetting* dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara ndër vite nga subjekti në ILDKPKI;
- d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- e) shpjegimet me shkrim, provat shkresore dhe argumentet e dhëna verbalisht në seancë dëgjimore nëpërmjet përfaqësuesit ligjor të subjektit të rivlerësimit të depozituara nëpërmjet postës elektronike dhe në seancë dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

23. Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni nisi shqyrtimin e deklarimeve të interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë te ky institucion, duke i krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit Elveta Stafa (Murra), pas:

- a) shqyrtimit të të dhënave të deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, me nr. indeksi ***, për subjektin e rivlerësimit;
- b) krahasimit të deklaratave të pasurive të dorëzuara në ILDKPKI për periudhën 2003 – 2016, në raport me të dhënat në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*;
- c) shqyrtimit të të dhënave nga të gjitha bankat e nivelit të dytë, institucionet financiare dhe jofinanciare, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, organet tatimore, organet e tjera shtetërore, personat juridikë, individët, si dhe likuiditeteve - gjendje *cash*;
- d) hetimit të kryer lidhur me të dhënat e vetëdeklaruara nga subjekti gjatë plotësimit të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni dhe provave shkresore të paraqitura prej saj.

Në deklaratën e pasurisë *Vetting*, të dorëzuar në ILDKPKI, subjekti i rivlerësimit Elveta Stafa (Murra) ka deklaruar pasuritë si vijojnë:

1. Apartament banimi, sip. 11.8 m2, në vlerën 5,552,157 lekë

1.1 Në deklaratën *Vetting* subjekti Elveta Stafa (Murra) ka deklaruar pasurinë apartament banimi sipërfaqe 11.8 m², 3+1, kati i ***, lagjja “****”, me vlerë 5.552.157 lekë. Subjekti ka deklaruar se nuk zotëron certifikatë pronësie për shkak të problemeve të sipërmarrësit me pronarët e truallit. Vlera: 4.700.000 lekë. Pjesa takuese: 50%.

Hetimi administrativ i Komisionit

1.2 Subjekti ka deklaruar pasurinë Apartament 3+1, kati i ***, lagja ***, Elbasan, sipërfaqe 11.8 m² në vlerën 5,552,157 lekë dhe vlerë 4,700,000 lekë.

1.3 Sipas deklaramit të subjektit pagesat për këtë pasuri janë likuiduar: (i) në vitin 2008, shuma prej 2,200,000 lekë; (ii) në vitin 2010, shuma 2,000,000 lekë; si dhe (iii) në vitin 2013, shuma 500,000 lekë, sipas kontratës së sipërmarrjes së datës 31.7.2008.

1.4 Si burim për blerjen e këtij apartamenti, subjekti ka deklaruar:

- a) të ardhura të përfituara nga shitja e apartamentit të mëparshëm 2+1, në vlerën 2,632,500 lekë (*i cili kishte burim të ardhurat nga shitja e pasurisë apartament në vlerën 150,000 lekë; të ardhurat e krijuara nga shitja e dy dhomave në datën 3.6.1997, në vlerën 400,000 lekë, si dhe kursimet familjare*);
- b) të ardhura nga shitja e sipërfaqes së tokës me sipërfaqe 2.100 m², në vlerën 4,200,000 lekë.

1.5 Shitja e apartamentit 2+1 në vlerën 2,632,500 lekë dhe shitja e pretenduar e tokës me sipërfaqe 2.100 m² janë kryer me kontratë në vitin 2009. Në DPV-në e vitit 2009 subjekti ka deklaruar se, të ardhurat nga shitja e pasurive apartament dhe tokë, në vlerën 5,500,000 lekë, i disponon cash në fund të këtij viti. Burimi i deklaruar për blerjen e kësaj pasurie nuk është i saktë.

1.6 Për këtë pasuri të deklaruar nga subjekti ka rezultuar kontratë sipërmarrje nr. ***, datë 31.7.2008, nënshkruar ndërmjet palës sipërmarrëse shoqëria ndërtuese “****” sh.p.k. dhe palës porositore I.M (për blerje të një apartamenti në lagjen “****”, Elbasan, me sipërfaqe 116.5 m², nga të cilat 104.7 m² do të jetë sipërfaqe brenda apartamentit dhe 11.8 m² sipërfaqe shërbimi). Sipas kësaj kontrate çmimi për ndërtimin e apartamentit do të jetë 44,435 euro (konvertuar në shumën 5,552,157 lekë). Apartamenti do të shlyhet me këste, ku vlera 2,200,000 lekë është likuiduar jashtë zyrës noteriale dhe kësti i dytë në shumën 3,352,147 lekë do të likuidohet brenda muajit shtator të vitit 2008.

1.7 Sipas kësaj kontrate sipërmarrje e gjithë shuma prej 5,552,157 lekësh, duhej të ishte shlyer brenda vitit 2008.

1.8 Me deklaratën noteriale nr. ***, datë 8.3.2013, palët deklaruese shtetasit I.M dhe V.P, deklarojnë se z. I.M në datën 6.3.2010 ka likuiduar shoqërinë “****” sh.p.k., në shumën 4,200,000 lekë, ndërsa këstin prej 500,000 lekësh e ka likuiduar ditën e nënshkrimit të këtij akti. Gjithashtu, z. V.P, në cilësinë e administratorit të shoqërisë “****” sh.p.k. pranon sa ka deklaruar më sipër I.M.

1.9 Kjo deklaratë noteriale nuk përkon me deklaratën *Vetting*, pasi subjekti ka deklaruar se në vitin 2008 është paguar shuma prej 2,200,000 lekësh dhe në vitin 2010 është paguar shuma prej 2,000,000 lekësh.

1.10 Komisioni hetoi lidhur me burimin e deklaruar nga subjekti për blerjen e kësaj pasurie dhe lidhur me deklaramet e subjektit për vlerat e shpenzuara dhe periudhat përkatëse, nga ku u konstatuan përsëri pasaktësi dhe deklarime të ndryshme nga subjekti, të cilat janë trajtuar në vijim.

1.11 Blerja e apartamentit 3+1, në rrugën “***”, Elbasan, me vlerë 5.552.157 lekë, nuk është deklaruar në DPV-në e vitit 2008. Gjithashtu, nuk është deklaruar as pagesa e pretenduar si e shpenzuar prej 2.200.000 lekësh (sipas deklaratës *Vetting*) në vitin 2008.

1.12 Në DPV-të për vitet 2008 dhe 2009, por as në DPV-të në vazhdim nuk është deklaruar detyrimi i mbetur ndaj palës shitëse për blerjen e pasurisë apartament. Po ashtu, as në DPV-në e vitit 2013 nuk është deklaruar pagesa e pretenduar për pagimin e këstit të fundit në shumën 500.000 lekë.

1.13 Në DPV-në e vitit 2010, subjekti ka deklaruar *paguar për blerjen e një apartamenti 3+1, në lagjen “***”, Elbasan, sipërmarrësit V.P, sipas aktmarrëveshjes datë 6.3.2010, shuma 4.200,000 lekë*, pa deklaruar më parë veprime juridike dhe kryera.

1.14 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar sipërfaqen e apartamentit 11.8 m², ndërsa nga kontrata e sipërmarrjes e vitit 2008, rezultoi apartamenti me sipërfaqe 116.5 m². Rezultoi deklarim i pasaktë i subjektit lidhur me sipërfaqen e pasurisë apartament.

1.15 Gjithashtu, rezultoi se ka mospërputhje të pagesave të kryera dhe periudhave kohore për këtë pasuri. Nga njëra anë, subjekti bazuar në kontratën e sipërmarrjes do të likuidonte brenda muajit shtator të vitit 2008, vlerën totale prej 5,552,157 lekësh, ndërsa nga ana tjetër ka deklaruar se është paguar në vitin 2008, shuma prej 2,200,000 lekësh, në vitin 2010 shuma prej 2,000,000 lekësh, gjithsej shuma 4,200,000 lekë dhe në vitin 2013 paguar shuma 500,000 lekë. Po ashtu, sipas deklaratës noteriale të vitit 2013 (me palë deklaruese shtetasit I.M dhe V.P) rezulton se shuma prej 4,200,000 lekësh është likuiduar deri në datën 6.3.2010, çka nënkupton likuidimin total në këtë vit.

1.16 Nisur nga këto problematika të konstatuara, është pyetur¹ subjekti, i cili në përgjigje të pyetësorit nr. 2² ka deklaruar se: *“Veprimet juridike nuk janë deklaruar në DPV-të vjetore, pasi kam menduar gjithmonë se me kontratën e shitblerjes do të deklaroja edhe blerjen e pasurisë apartament, ku dhe do të sqaroja pagesat përkatëse të kryera. Në momentin e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes kam menduar se dokumentet e pronësisë për objektin do të dilnin shpejt dhe do të deklaroja kështu kontratën përfundimtare të shitblerjes. Ka qenë pasaktësi nga ana ime mosdeklarimi në DPV-në e vitit 2008 të kontratës së sipërmarrjes dhe vlerës së paguar në këtë vit për blerjen e apartamentit”*.

1.17 Ndërsa, në lidhje me ndryshimin e sipërfaqes së apartamentit nga deklarata *Vetting* me atë të kontratës së sipërmarrjes, subjekti ka deklaruar se *nuk ka ndryshim ndërmjet sipërfaqes së deklaruar në deklaratën *Vetting* me sipërfaqen e përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes. Në deklaratën *Vetting* gabimisht është shkruar vetëm sipërfaqja e përbashkët 11.8 m². Sipërfaqja e përgjithshme e apartamentit është 116.5 m² nga të cilat 104.7 m² është sipërfaqja e ndërtimit e brendshme dhe 11.8 m² sipërfaqet e përbashkëta.*

1.18 Për mospërputhjet e pagesave të kryera, subjekti është përgjigjur duke thënë se: *“Deklarata noteriale nënshkruar prej bashkëshortit tim dhe shtetasit V.P administrator i shoqërisë ‘***’ sh.p.k. përcakton se deri më 6.3.2010, i kemi likuiduar shoqërisë shumën 4,200,000 lekë. Transaksionet e blerjes nuk janë kryer në datën 6.3.2010, sikurse lë të kuptohet deklarata noteriale, por deri në datën 6.3.2010 është likuiduar shuma 4,200,000 lekë. Në momentin e nënshkrimit të deklaratës është paguar edhe kësti në shumën 500.000 lekë. Ndërmjet kontratës përfundimtare të shitblerjes dhe pagesave reale të kryera ka pasur mospërputhshmëri e krijuar kjo prej vetë shoqërisë ndërtuese ‘***’ sh.p.k. Pagesat për blerjen e apartamentit janë bërë: (i) shuma 2,200,000 lekë në momentin e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes; (ii) shuma 2,000,000 lekë, në datën 6.3.2010; (iii) shuma 500,000 lekë, në datën*

¹Shihni pyetjet në pyetësorin nr. 2.

²Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 2.

8.3.2013; (iv) shuma 500,000 lekë, në datën 11.5.2017, përpara momentit të lidhjes së kontratës përfundimtare të shitjes. Shumës së përgjithshme të vlerës së apartamentit është zbritur shuma 360,000 lekë nga shoqëria ‘***’ sh.p.k. për punimet të cilat i kam kryer vetë në vitin 2010. Kontrata e sipërmarrjes dhe deklarata noteriale janë dokumente që vërtetojnë pagesat e kryera. Për pagesën në momentin e nënshkrimit të kontratës përfundimtare nuk kam asnjë dokument pasi kjo shumë i është dhënë dorazi ndërtuesit”.

Lidhur me burimet e krijimit të pasurisë

1.19 Në lidhje me burimet financiare, që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit, vitet, si dhe burimin e krijimit të pasurive të shitura që kanë shërbyer për pagimin e detyrimeve për blerjen e kësaj pasurie, subjekti ka shpjeguar se: “Kësti i parë në shumën 2,200,000 lekë kryer në datën 31.7.2008 është nga pakësimi i gjendjes cash dhe të ardhurat e bashkëshortit nga vreshtaria; kësti i dytë në shumën 2,000,000 lekë dhe punimet e kryera në vlerën 360,000 lekë janë kryer nga pakësimi i gjendjes cash në vitin 2009, kjo gjendje cash është krijuar nga shitja e garsonieres në Pogradec dhe nga kontrata e premtim shitjes së tokës me sip. 2100 m². Në fund të vitit 2009 gjendja cash ka qenë në shumën 5,500,000 lekë, e cila është pakësuar gjatë vitit 2010, duke deklaruar në fund të vitit 2010 një gjendje në shumën 1,694,050 lekë (shihni tabelën me poshtë); kësti i tretë në shumën 500,000 lekë, në datën 8.3.2013 është po ashtu nga pakësimi i gjendjes cash deklaruar në fund të vitit 2012; si dhe kësti i katërt në shumën 500,000 lekë paguar në datën 11.5.2017, me pakësimin e gjendjes cash në fund të vitit 2016”.

1.20 Për faktin, nëse subjekti i rivlerësimit është gjendur në situatë konflikti interesi, me palë shoqërinë “***” sh.p.k., apo ortakët e administratorët e saj, subjekti ka sjellë një shkresë³ me lëndë, kthim përgjigje, të lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, ku pas verifikimeve rezulton se...nuk është regjistruar ndonjë material kallëzues apo procedim penal në emër të “***” sh.p.k., apo ortakët e administratorët e saj.

1.21 Subjekti nuk ka deklaruar punime të kryera për këtë pasuri nga vetë ajo, në vlerën prej 360,000 lekë në vitin 2010, por kur përgjigjet për pagesat dhe vitet e kryerjes së pagesave të apartamentit, ajo deklaron se, shumës së përgjithshme të vlerës së apartamentit i është zbritur vlera prej 360,000 lekë nga shoqëria *** sh.p.k., për punimet të cilat i kam kryer vetë në vitin 2010.

1.22 Subjekti nuk ka deklaruar as ndryshime të gjendjes cash në DPV-të periodike, me qëllim blerjen e kësaj pasurie apo shlyerje pagesash ndaj palës shitëse.

1.23 Kontrata e shitjes për këtë pasuri është hartuar para noterit në datën 31.10.2017. Bazuar në këtë kontratë pasuria apartament me sip. 104.7 m² është në vlerën 45,435 euro. Likuidimi i kësaj vlere monetare është bërë paraprakisht, në monedhën lekë, pa pasur asnjë lloj pretendimi ligjor dhe financiar nga palët dhe vërtetohet sipas mandateve të lëshuar nga shoqëria “***” sh.p.k., konkretisht: (i) vlera 2,200,000 lekë, likuiduar më 1.8.2008, sipas mandatit nr. ***; (ii) vlera 600,000 lekë, likuiduar më 27.11.2008, sipas mandatit nr. ***; (iii) vlera 400,000 lekë, likuiduar më 2.12.2008, sipas mandatit nr. ***; (iv) vlera 1,000,000 lekë, likuiduar më 18.12.2008, sipas mandatit nr. ***; (v) vlera 1,300,000 lekë, likuiduar më 25.5.2009, sipas mandatit nr. ***; (vi) vlera 50,000 lekë, likuiduar sipas mandatit nr. ***.

1.24 Lidhur me transaksionet e apartamenteve të shitura nga subjekti dhe tokës arë në qytetin e Elbasanit, që janë deklaruar se kanë shërbyer si burim krijimi i apartamentit 3+1, rezultoi:

i) Kontratë shitblerje pasurie të paluajtshme nr. ***, datë 5.5.2009, nënshkruar ndërmjet palës shitëse Elveta Murra, me pëlqimin e bashkëshortit I.M dhe palës blerëse B.P, të apartamentit të ndodhur në lagjen “***”, me nr. pasurie ***, sip. 65 m². Çmimi i shitjes së apartamentit në

³Shihni shkresën datë 8.11.2021, sjellë si dokument provues me përgjigjen e pyetësorit nr. 2.

shumën 2,632,500 lekë. Pala shitëse deklaroi se në favor të tyre është depozituar kjo shumë, jashtë zyrës noteriale dhe para hartimit të kësaj kontrate. Kartela e pasurisë së paluajtshme, nr. ***, lloji “apartament”, me sip. 65 m², ndodhur në lagjen “****”, Elbasan, p. ***, sh. ***, k. ***, ap. ***, regjistruar më 14.5.2019, në emër të shtetasit B.P.

ii) Kontratë shitje banese nr. ***, datë 15.1.1997, nënshkruar ndërmjet palës shitëse I.M e Elveta Murra dhe palës blerëse G.P, të një apartamenti 1+1, e ndodhur në lagjen “ *** ”, p.***, nr. ***, kundrejt shumës 150,000 lekë. Palët deklarojnë se janë likuiduar ndërmjet tyre, jashtë zyrës noteriale.

iii) Kontratë shitblerje nr. ***, datë 3.6.1997, nënshkruar ndërmjet palës shitëse I.M e Elveta Murra dhe palës blerëse J.P, të një shtëpie të ndodhur në lagjen “****”, p. ***, ap. ***, kundrejt shumës 400,000 lekë, shumë e cila është likuiduar nga shitësi tek blerësi. Bashkëlidhur kartela e pasurisë së paluajtshme “apartament” me nr. ***, me sip. 27 m², regjistruar në datën 2.6.2015, në emër të J.P.

iv) Aktmarrëveshje datë 29.12.2009, nënshkruar para avokates M.D, nga pala shitëse I.M dhe palës premtuese për blerje F.H, për shitblerjen e një sipërfaqe toke nga parcela e marrë në pronësi në bazë të ligjit nr. 7501, “Për tokën”, i ndryshuar, nga shtetasi I.M, me emërtimin “****, sipër magazinës”, me sip. totale 2100 m². Çmimi i shitjes së pronës në shumën totale 4.200.000 lekë, është likuiduar jashtë zyrës noteriale. Pas nënshkrimit të kësaj aktmarrëveshje, prona i kalon në përdorim shtetasit F.H.

1.25 Subjekti ka deklaruar se apartamenti i mëparshëm prej 2+1 i është shitur shtetasit B.P, në vlerën 2,632,500 lekë. Ky apartament ka qenë blerë nga subjekti me kontratën e shitblerjes nga shtetasi D.A etj., në shumën 1,150,000 lekë. Burim për blerjen e kësaj pasurie janë deklaruar të ardhurat e siguruar nga shitja e apartamentit 1+1, në lagjen “****”, pallati ***, sipas kontratës së shitblerjes, datë 15.1.1997, me shtetasin G.P, në shumën 150,000 lekë; nga të ardhurat e krijuara nga shitja e dy dhomave në pallatin nr. ***, kati *** të përfuturara mbas privatizimit sipas kontratës nr. ***, datë 3.6.1997, me shtetasin J.P në vlerën 400,000 lekë, si dhe kursimet familjare.

1.26 Rezultoi se subjekti ka pasur në pronësi, një pasuri banesë, të përbërë nga dy dhoma dhe një kuzhinë, e llojit “apartament”, me sip. 65 m², blerë me kontratë shitblerje nr. *** datë 12.11.1997, D, N, A, S e Sh. A, kundrejt shumës 1,150,000 lekë, ndodhur në lagjen “****”, Elbasan, z. k. ***, me nr. *** pasurie, të cilën e ka shitur me kontratë shitje nr. ***, datë 5.5.2009, palës blerëse B.P. Çmimi i shitjes së apartamentit është 2,632,500 lekë.

1.27 Nga statement bankar të llogarisë në emër të bashkëshortit të subjektit I.M në BKT, në datën 14.5.08, rezultoi një kalim në vlerën 2,200,000 lekë nga llogari e depozitës në emër të shtetasit B ose S.P (blerësit e apartamentit në lagjen “****”, në vitin 2009), te llogari depozitë në emër të shtetasit I.M. Në datën 1.8.2008, mbyllet kjo llogari nga shtetasi I.M, pra, një ditë pas nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes me shoqërinë “****” sh.p.k., për blerjen e apartamentit në rrugën “****”. Sipas kësaj kontrate sipërmarrje në datën 31.7.2008, ishte paguar vlera 2,200,000 lekë, por mbeti i paqartë momenti kohor i arkëtimit të të ardhurave (më 14.5.2008), pra, një vit më parë nga shitja e apartamentit në lagjen “****” (më 5.5.2009).

1.28 Në analizën financiare, të ardhurat nga shitja e apartamentit në lagjen “ ****” janë llogaritur në vitin 2009. Kështu, vlera e tërhequr nga depozita bankare nga z. I.M në datën 1.8.2008, në shumën 2,211,755 lekë është konsideruar si e shpenzuar në vitin 2008, për arsye se, subjekti nuk provoi se këto të ardhura kanë shërbyer për blerjen e pasurisë apartament në vitin 2008.

1.29 Në deklaratën e pasurisë të vitit 2003, subjekti ka deklaruar: “Shtëpi banimi me sip. 60 m², blerë 2,5 milion lekë, lagjja ‘****’, blerë në vitin 1997 me lekët e marra nga shitja e një banese të mëparshme 1+1 dhe kursimet, pjesa që zotëron 35%”.

Për këtë subjektit iu kërkua të deklaronte nëse bëhet fjalë për të njëjtën pasuri blerë në vitin 1997, apartament me sip. 65 m², nga z. D.A etj., në vlerën 1,150,000 lekë, apo është një pasuri tjetër e blerë në vlerën 2,500,000, po me sip. 60 m²?!

Në përgjigje të pyetsorit nr. 3, subjekti, ndër të tjera, deklaroi se: “...deklarimi i vitit 2003 ka pasaktësi pasi bëhet fjalë për apartamentin 2+1 me sip. 65 m² në lagjen ‘ ***’ (***) blerë shtetasit D.A në vlerën 1,500,000 lekë në vitin 1997. Pra, bëhet fjalë për të njëjtën pasuri...”.

Nga Komisioni, kjo pasuri në analizën financiare u vlerësua në vlerën 1,150,000 lekë, sipas kontratës së shitblerjes.

1.30 Bazuar në shkresat e ZQRPP-së dhe ZVRPP-së Elbasan, është konstatuar se:

- a) Subjekti ka pasur në pronësi së bashku me shtetasin I.M (blerë kundrejt shumës 500,000 lekë, në vitin 1996, me kontratën nr. ***, palës shitëse M.H), pasurinë nr. ***, z. k. ***, apartament me sip. 60 m², ndodhur në lagjen “***”, Elbasan, të cilën e kanë shitur me kontratë shitje nr. ***, datë 25.1.1997, në vlerën 150,000 lekë.
- b) Subjekti ka pasur në pronësi së bashku me shtetasin I.M, pasurinë nr. ***, z. k. ***, e llojit apartament, me sip. 27 m², ndodhur në lagjen “***”, Elbasan, të cilën e kanë shitur me kontratë shitje nr. ***, datë 3.6.1997, në vlerën 400,000 lekë (përfituar nga kontrata për privatizim banese në vitin 1993, kundrejt vlerës 5,803 lekë).

1.31 Shitja e pasurisë tokë me sipërfaqe 2100 m² nuk është bërë në formën e kërkuar nga ligji, por me anë të një aktmarrëveshje të thjeshtë. Nuk provohet dhe dokumentohet kalimi i shumës për këtë veprim, si dhe nuk rezulton se janë paguar detyrimet përkatëse në buxhetin e shtetit lidhur me të ardhurat e pretenduara në shumën prej 4,200,000 lekësh. Nga ana tjetër, të ardhurat e pretenduara nga shitja e tokës me sip. 2100 m², sipas aktmarrëveshjes, janë marrë në dhjetor të vitit 2009, ndërkohë sipas kontratës së shitblerjes së apartamentit në rrugën “***”, kësti i paguar në vitin 2009, në shumën prej 1,300,000 lekësh, daton më 25.5.2009. Pra, të ardhurat e pretenduara nga shitja e tokës-vresht në dhjetor të vitit 2009, nuk mund të konsiderohen si burim për pagesën e kështit të vitit 2009 për blerjen e apartamentit. Gjithashtu, këto të ardhura në shumën prej 4,200,000 lekësh nuk kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie, jo vetëm se nuk provohet burimi i ligjshëm i tyre, por edhe sepse këto të ardhura janë deklaruar në DPV-në e vitit 2009, si gjendje *cash* në banesë në fund të vitit 2009.

1.32 Analiza financiare

Analiza financiare, për periudhën 1985– 1997, për blerjen e apartamenti me sip. 65 m², lagjja “*”, Elbasan**

PËRSHKRIMI	Periudha 1985 - 1997
PASURI	1,655,803
Apartament me siop. 65 m ² , 2+1, lagjja “***”, Elbasan, 1997 - Elveta Murra	1,150,000
Apartament me sip. 27 m ² , lagjja “***”, Elbasan - 1993 - Elveta + I.M	5,803
Apartament me sip. 60 m ² , 1+1, lagjja “***”, Elbasan - 1996 - Elveta + I.	500,000
Tokë me sip. 2100 m ² , ***, Elbasan, privatizim nga ndërmarrja bujqësore	0
DETYRIME	0

PASURI NETO (PASURI - DETYRIME)	1,655,803
----------------------------------------	------------------

TË ARDHURA dokumentuar	1,276,123
Të ardhura nga puna subjekti Elveta Murra	689,465
Të ardhura nga puna bashkëshorti I.M	36,658
Të ardhura nga shitja e apartamentit, me sip. 60 m ² , Elbasan - 1997	150,000
Të ardhura nga shitja e apartamentit, me sip. 27 m ² , Elbasan - 1997	400,000
SHPENZIME	550,791
Shpenzime jetese	526,291
Shpenzime për tokën vresht 1996-1997	20,000
Shpenzime për tatim shitje pasuri të paluajtshme	4,500

Analiza dokumentuar	-930,471
----------------------------	-----------------

1.33 Analiza financiare, për periudhën 1985 – 1997, u bë për të parë mundësinë e subjektit për blerjen e pasurisë apartament me sip. 65 m², në lagjen “****”, e cila është deklaruar nga subjekti se ka shërbyer si burim për blerjen e apartamentit në rrugën “****”.

Nga analiza financiare, për periudhës 1985 – 1997, subjekti rezulton me një pamjaftueshmëri financiare për blerjen e pasurisë apartament me sip. 65 m², në lagjen “****”, blerjes së pasurive të tjera dhe mbulimin e shpenzimeve të periudhës.

Si rrjedhim, të ardhurat nga shitja e këtij apartamenti, nuk u konsideruan si burim i ligjshëm për blerjen e pasurisë apartament në rrugën “****” dhe, si të tilla, nuk u përfshinë në analizën financiare të mundësisë së blerjes së kësaj pasurie.

Analiza e mundësisë së blerjes së apartamentit në lagjen “**”, Elbasan**

Përshkrimi	Vlera
Të ardhura nga shitja e apartamentit me sip. 60 m ² , lagja “****”, Elbasan - 2009	0
Të ardhura nga shitja e tokës vresht me sip. 2,100 m ² - 2009	0
Të ardhura totale	0
Blerje apartamenti me sip. 60 m ²	5,500,000
Punime shtesë në apartament - 2010	360,000
Pamundësia financiare	-5,860,000

Sipas analizës financiare, rezultoi se subjekti dhe bashkëshorti nuk kishin burime të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e pasurisë apartament në rrugën “**”, Elbasan**

Analiza financiare është hartuar duke u bazuar në kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 31.10.2017 dhe mandatpagesave të bashkëlidhura kësaj kontrate dhe të firmosura nga palët kontraktore.

1.34 Burimet e krijimit të këtyre pasurive nuk provohen nga subjekti me dokumentacion të ligjshëm dhe bazuar në analizën financiare, subjekti nuk ka pasur mundësi financiare për krijimin e pasurive apartament si më sipër.

1.35 Në përfundim të hetimit, Komisioni hartoi konkluzione për të cilat i kaloi barrën e provës subjektivit të rivlerësimit si vijon:

Ka mospërputhje, pasaktësi dhe pamundësi financiare nga burime të ligjshme për krijimin e pasurisë apartament me sipërfaqe 116.5 m², në rrugën “****”, për shkak se:

i. Subjekti nuk ka deklaruar saktë në deklaratën *Vetting* vlerën, burimin e krijimit të kësaj pasurie dhe periudhën e shlyerjes së detyrimeve ndaj palës shitëse, krahasuar me mandatarkëtimet bashkëlidhur kontratës së shitjes në datën 31.10.2017.

ii. Ka mospërputhje lidhur me vlerën e deklarimit të kësaj pasurie, midis deklaratës *Vetting*, në të cilën janë dhënë 2 vlera të ndryshme për blerjen e kësaj pasurie, njëra në shumën 5,552,157 lekë dhe tjetra në vlerën prej 4,700,000 lekësh.

iii. Ka deklarime dhe të dhëna kontradiktore lidhur me kohën/periudhën e likuidimit të kësaj pasurie, si vijon:

a) sipas deklaratës *Vetting*, pagesat për këtë pasuri, janë bërë në vitin 2008 në shumën 2,200,000 lekë; në vitin 2010 në shumën prej 2,000,000 lekë; si dhe në vitin 2013 paguar shuma 500,000 lekë;

b) ndërkohë, sipas kontratës së sipërmarrjes, datë 31.7.2008, çmimi për ndërtimin e apartamentit do të jetë në shumën 5,552,157 lekë dhe apartamenti do të shlyhet me këste, ku vlera 2,200,000 lekë është likuiduar jashtë zyrës noteriale dhe kësti i dytë në shumën 3,352,147 lekë, do të likuidohet brenda muajit shtator të vitit 2008;

c) ndërkohë, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se kësti i parë në shumën 2,200,000 lekë kryer në datën 31.07.2008, kësti i dytë në shumën 2,000,000 lekë dhe punimet e kryera në vlerën 360,000 lekë në vitin 2009, kësti i tretë në shumën 500,000 lekë në datën 8.3.2013, si dhe kësti i katërt në shumën 500,000 lekë është paguar më 11.5.2017;

d) ndërsa, bazuar në kontratën e shitblerjes, datë 31.10.2017, rezulton se vlera 2,200,000 lekë është likuiduar në datën 1.8.2008; vlera 600,000 lekë, likuiduar në datën 27.11.2008; vlera 400,000 lekë, likuiduar në datën 2.12.2008; vlera 1,000,000 lekë, likuiduar në datën 18.12.2008; vlera 1,300,000 lekë, likuiduar në datën 25.5.2009; si dhe vlera 50,000 lekë, likuiduar sipas mandatit nr. ***.

iv. Ka deklarime kontradiktore dhe të pasakta lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie si vijon:

a) Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar se si burim për krijimin e kësaj pasurie janë të ardhurat nga shitja e apartamentit në vitin 2009, në vlerën prej 2,632,500 lekë dhe të ardhurat nga shitja e sipërfaqes së tokës me sip. 2100 m², në vlerën 4,200,000 lekë.

b) Ndërkohë që në përgjigje të pyetësorit, subjekti, gjatë hetimit, ka deklaruar se: kësti i parë në shumën 2,200,000 lekë është nga pakësimi i gjendjes *cash* dhe të ardhurat e bashkëshortit nga vreshtaria; kësti i dytë në shumën 2,000,000 lekë dhe punimet e kryera në vlerën 360,000 lekë janë kryer nga pakësimi i gjendjes *cash* në vitin 2009; kësti i tretë prej 500,000 lekë është, po ashtu, nga pakësimi i gjendjes *cash* deklaruar në fund të vitit 2012; si dhe kësti i katërt në vlerën 500,000 lekë paguar në datën 11.5.2017, me pakësimin e gjendjes *cash* në fund të vitit 2016.

v. Subjekti nuk ka deklaruar gjendje *cash* në vitet 2007 dhe 2008 apo ndryshim të kësaj gjendjeje. Në DPV-në e vitit 2009, subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në shumën prej 5,500,000 lekësh (të ardhura nga shitja e apartamentit dhe tokës), pra, gjendje *cash* dhe jo zvogëlim të gjendjes *cash*.

- a) Referuar burimit të deklaruar në deklaratën *Vetting*, për blerjen e kësaj pasurie nga të ardhurat e përfituara nga shitja e tokës në shumën 4,200,000 lekë, subjekti i rivlerësimit nuk ka vërtetuar se për këto të ardhura janë paguar detyrimet tatimore, në përputhje me ligjin mbi të ardhurat, duke qenë se nuk ka pasur një kontratë shitblerje midis palëve. Për këtë arsye, këto të ardhura nuk janë marrë në konsideratë në analizë financiare.
- b) Por, edhe po t'i referohemi mandatarkëtimeve bashkëlidhur kontratës së shitjes së vitit 2017, të ardhurat nga shitja e tokës me sip. 2100 m², në shumën 4.200.000 lekë, nuk mund të kenë shërbyer si burim për pagimin e vlerës 1,300,000 lekë, likuiduar në datën 25.5.2009, sipas mandatit nr. ***, pasi aktmarrëveshja për shitjen e kësaj toke daton në dhjetor të vitit 2009. Të ardhurat e pretenduara nga shitja e tokës vresht janë deklaruar në DPV-në e vitit 2009, si gjendje në shtëpi.

vi. Subjekti ka bërë deklaram të paplotë dhe të parregullt mbi këtë pasuri në DPV-të, ndër vite, për shkak se:

- a) subjekti nuk ka deklaruar kontratën e sipërmarrjes në DPV-në e vitit 2008, me vlerë 5,552,157 lekë dhe pagimin e shumës 2,200,000 lekë, likuiduar në momentin e nënshkrimit të kontratës, nëse i referohemi deklaratës *Vetting*;
- b) subjekti nuk ka deklaruar në DPV-në e vitit 2008, pagesat e kryera në shumën 2,000,000 lekë (600.000 lekë + 400.000 lekë + 1.000.000 lekë), nëse i referohemi mandatarkëtimeve bashkëlidhur kontratës së shitjes;
- c) në DPV-në e vitit 2009, subjekti nuk ka deklaruar blerjen e kësaj pasurie as shpenzime të kryera gjatë këtij vitit për pagim kësti;
- d) në DPV-në e vitit 2009, subjekti ka deklaruar se të ardhurat nga shitja e pasurive apartament dhe tokë, i disponon *cash*, në vlerën 5,500,000 lekë;
- e) në DPV-në e viteve 2008 deri në 2016, nuk është deklaruar detyrimi i mbetur ndaj palës shitëse për blerjen e pasurisë apartament;
- f) në DPV-në e vitit 2010, subjekti ka deklaruar: “... *paguar për blerjen e një apartamenti 3+1, në lagjen ‘***’, Elbasan, sipërmarrësit V.P, sipas aktmarrëveshjes, datë 6.3.2010, në vlerën 4.200,000 lekë*”, por nuk ka deklaruar më parë veprime juridike dhe pagesa të kryera;
- g) Në DPV-në e vitit 2010, subjekti nuk deklaroi shpenzimet e punimeve të bëra në vlerën 360,000 lekë, tek apartamenti në lagjen “***”, Elbasan, të cilat i deklaroi për herë të parë në përgjigje pyetëso;
- h) në DPV-në e vitit 2013, nuk është deklaruar pagesa e pretenduar për pagimin e këstit të fundit në vlerën 500.000 lekë.

vii. Subjekti ka burime financiare të ligjshme të pamjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie në lagjen “***”, Elbasan, në shumën prej 5,860,000 lekësh.

viii. Subjekti ka burime financiare të pamjaftueshme për blerjen e pasurisë në lagjen “***”, në shumën 930,471 lekë, e cila ka shërbyer, sipas subjektit, si burim për blerjen e pasurisë në lagjen “***”.

1.36 Për gjetjet e mësipërme, subjektit të rivlerësimit iu kalua barrë e provës, për të dhënë argumentet dhe paraqitur prova, për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

1.37 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti, në prapësimet e datë 31.3.2022, ka deklaruar se: “ ... *në deklaramin *Vetting* gabimisht është shënuar sipërfaqja 11.8 m², për apartamentin 3+1, lagja ‘***’, Elbasan. Kjo është vetëm sipërfaqja e përbashkët. Sipas kontratës së sipërmarrjes sipërfaqja e përgjithshme e apartamentit është 116.5 m², nga të cilat sipërfaqe shfrytëzimi 104.7 m² dhe sipërfaqe e përbashkët 11.8 m².*”

*Pagesat e kryera për këtë pasuri janë: shuma 2,200,000 lekë, paguar në datën 1.8.2008 me mandatarkëtim nr. ***; shuma 600,000 lekë, paguar në datën 27.11.2008, me mandatarkëtim nr. ***; shuma 400,000 lekë, paguar në datën 02.12.2008, me mandatarkëtim nr. ***; shuma 1,000,000 lekë, paguar në datën 18.12.2008, me mandatarkëtim nr. ***; shuma 1,300,000 lekë paguar, në datën 25.5.2009, me mandatarkëtim nr. ***; si dhe shuma 50,000 lekë, paguar në datën 31.10.2017, me mandatarkëtim nr. ***.*

*Këstet e paguara janë saktësuar në momentin e hartimit të kontratës së shitblerjes, datë 31.10.2017, kur janë disponuar mandat arkëtimet origjinale, sepse mandatarkëtimet kopje ishin të palexueshme. Pas analizës financiare të bërë nga ana ime mendoj se, mundësia financiare për blerjen e apartamentit 3+1, në lagjen “***” është e mjaftueshme (shihni tabelën me poshtë).*

*Burimi i të ardhurave: likuiduar për apartamentin në vitin 2008, në shumën 4,200,000 lekë, të cilat janë përballuar nga: të ardhura nga puna ime në vlerën 852,073 lekë; të ardhura nga puna bashkëshorti I.M, sipas shkresës nr. *** prot., datë 21.07.2017, të Bashkisë Elbasan, të ardhura neto në shumën 960,000 lekë; si dhe të ardhura nga shitja e pasurisë vresht me sip. 2100 m², shitje me aktmarrëveshje posedimi në përdorim, blerës F.H në shumën 4,200,000 lekë.*

*Likuiduar për apartamentin në vitin 2009, shumën 1,300,000 lekë, të cilat janë përballuar nga: të ardhura nga puna ime në shumën 924,746 lekë; të ardhura nga puna e bashkëshortit I.M, sipas shkresës së nr. *** prot., datë 21.7.2017, të Bashkisë Elbasan, të ardhura neto në shumën 1,440,000 lekë; të ardhura nga shitja e apartamentit me sip. 65 m², 2+1, nr. pasurie *** , lagjja “***”, Elbasan, në shumën 2,632,500 lekë.*

Për sa i përket të ardhurave të përfituara nga shitja e sipërfaqes së tokës vresht në vlerën 4,200,000 lekë, është e vërtetë se nuk janë paguar detyrimet tatimore, por një detyrim i tillë do të paguhet menjëherë në momentin e regjistrimit të saj në Kadastër pas bërjes së kontratës përfundimtare”.

1.38 Përfaqësuesi i subjektit të rivlerësimit në seancën dëgjimore⁴ mbajti të njëjtin qëndrim me parashtrimet e paraqitura në datën 31.3.2022 dhe me ato të paraqitura në rrugë zyrtare më 27.4.2022, të cilat i ridepozitoi përsëri bashkë me dokumentet⁵, për të cilat kërkoi që Komisioni t'i konsideronte përpara vendimmarrjes së tij.

Vlerësimi i Komisionit

1.39 Subjekti i rivlerësimit në deklaratën Vetting ka deklaruar në mënyrë të pasaktë sipërfaqen e apartamentit në lagjen “***”, nga 116.5 m² (nga ku 104.7 m² sipërfaqe e shfrytëzueshme dhe 11.8 sipërfaqe e përbashkët) në 11.8 m². Por, këtë Komisioni e konsideroi si një lapsus në plotësimin e deklaratës.

1.40 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në mënyrë të pasaktë e të pamjaftueshme burimin e krijimit të pasurisë apartament dhe mënyrën e pagesës së këtij apartamenti.

1.41 Pas plotësimit me dokumentacion provues plotësues të sjellë në prapësimet e datës 31.3.2022, Komisioni bëri pjesë të analizës të ardhurat nga puna e subjektit të rivlerësimit, për periudhën 1993 – 1995, si hetuese në Prokurorinë e Rrethit Elbasan, në vlerë totale 21,350 lekë. Këto të ardhura kanë një ndikim të papërfillshëm në analizën e mundësisë së blerjes së apartamentit me sip. 65 m², në lagjen “***”, e cila rezulton në një pamjaftueshmëri financiare në vlerën 924,066 lekë.

⁴Shihni parashtrimet e përfaqësuesit të subjektit dhe qëndrimet e mbajtura në seancat dëgjimore.

⁵Bashkëlidhur parashtrimeve subjekti ka sjellë dokumentet: akteksptimin kontabël; akteksptimin në lidhje me të ardhurat nga sip. e tokës prej 2100 m², deri në vitin 2009; shkresa të shtetit gjerman lidhur me qëndrimin në azil të djalit; kontratë shitje nr. *** , datë 8.8.2006; deklaratë noteriale datë 26.4.2020 e deklaruesit F.H, vendime emërimi të subjektit; tabela për shpenzimet dhe deklarime lidhur me personat e lidhur.

1.42 Lidhur me të ardhurat e pretenduara nga subjekti për bashkëshortin tek ish-NB Elbasan, për vitet 1985 – 1993, në vlerën 68,250 lekë, subjekti nuk provon me dokumentacion vlerën e këtyre të ardhurave. Gjithsesi, të ardhurat para vitit 1992, sipas vendimit nr. ***, datë 9.7.2019, të Kolegjit, janë të pa konsiderueshme dhe nuk kanë efekt financiar, pasi për këtë periudhë shpenzimet për jetesë janë konsideruar nga Kolegji në masën 100% të të ardhurave.

1.43 Referuar statement bankar dhe shpjegimeve të subjektit në prapësime, në analizën financiare pjesa e të ardhurave të arkëtuara me bankë në vitin 2008 nga shtetasi B.P, janë përfshirë tek të ardhurat e ligjshme të vitit 2008, te analiza në pikën 7, në vijim të këtij vendimi.

1.44 Pjesa e mbetur nga çmimi i shitjes së apartamentit në lagjen “***”, në vlerën 432,500 lekë, është përfshire tek të ardhurat e ligjshme të vitit 2009, vit kur është bërë kontrata e shitblerjes.

1.45 Komisioni nuk përfshiu në vlerësim si burim për krijimin e kësaj pasurie të ardhurat nga shitja e sipërfaqes së tokës me sipërfaqe 2.100 m², në vlerën 4,200,000 lekë. Subjekti nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm të këtyre të ardhurave të pretenduara dhe pagimin e detyrimeve përkatëse në buxhetin e shtetit. Aktmarrëveshja për këtë sipërfaqe toke rezultoi në fund të vitit 2009, periudhë, kur sipas kontratës së shitjes ishin shlyer të gjitha detyrimet ndaj palës blerëse të apartamentit dhe, për më tepër, subjekti këto të ardhura i ka deklaruar si gjendje *cash* në fund të vitit 2009 (shihni DPV-në e vitit 2009).

1.46 Komisioni nuk bëri pjesë të analizës të ardhurat e pretenduara nga sipërfaqja e tokës prej 2100 m² të mbjella me kulturën e rrushit deri në vitin 2009, në vlerën 152,020 lekë të reja, në vit, sepse vlerat e pretenduara nga eksperti vlerësues janë hipotetike dhe sepse nuk vërtetohet të jetë paguar ndonjë detyrim tatimor mbi këto të ardhura të pretenduara nga subjekti në prapësime. Subjekti kishte pretenduar vetëm të ardhura nga dhënia në përdorim i kësaj toke në vitet 2006 – 2008, në deklaratat periodike vjetore dhe në përgjigje të pyetësorit standard dhe jo të ardhura nga shfrytëzimi i saj.

1.47 Subjekti nuk ka burime financiare të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie në lagjen “***”, në shumën 5,860,000 lekë, sipas deklaratimit të bërë në deklaratën *Vetting*, lidhur me burimin e krijimit të pasurisë.

1.48 Në përfundim, Komisioni vlerësoi se subjekti ka bërë deklaratim të pasaktë, të pamjaftueshëm dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e pasurisë apartament në lagjen “***”, në vlerën prej 5,860,000 lekë, duke u gjendur kështu në kushtet e përcaktuara në germat “a” dhe “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

2. Apartament 1+1, me sipërfaqe 60 m², me vlerë 2,200,000 lekë, në Pogradec

2.1 Subjekti në deklaratën *Vetting* ka deklaruar se ka blerë apartament 1+1, kati ***, me sipërfaqe 60 m², Pogradec, me vlerë 2,200,000 lekë, sipas aktmarrëveshjes, datë 17.8.2010, me pronarin e truallit A.B. Nuk zotëron certifikatë pronësie. Pjesa takuese: 50%.

Hetimi administrativ i Komisionit

2.2 Burimi i krijimit: (a) të ardhurat nga shitja e garsonierës me sip. 25 m², në Pogradec, në vlerë 1,152,000 lekë. Kjo garsonierë është deklaruar në vitin 2004 dhe është paguar me këste deri në vitin 2006, kur është nënshkruar kontrata e shitblerjes me shitësin F.H, në vlerën e 700,000 lekëve; (b) të ardhura nga puna e bashkëshortit si avokat, kursimet e akumuluar, ndër vite, nga të ardhurat nga pagat e saj dhe të bashkëshortit si avokat; (c) të ardhura nga kthimi i një pjese të detyrimit nga shtetasja F.Zh; (ç) të ardhura të përfituara nga shitja e automjetit tip “***”, me targa ***, shtetases D.O.

2.3 Për këtë pasuri rezultoi dokumentacion si vijon:

- kontratë shitblerje nr. ***, datë 20.12.2006, nënshkruar ndërmjet palës shitëse F.H dhe palës blerëse Elveta Murra, të një apartamenti me sip. 25 m², me nr. pasurie ***, e ndodhur në Lagjen nr. ***, Pogradec. Çmimi i shitjes së pasurisë në shumën 700,000 lekë është likuiduar para redaktimit të kontratës, jashtë zyrës noteriale;
- kontratë shitblerje nr. ***, datë 11.8.2010, nënshkruar ndërmjet palës shitëse Elveta Murra dhe palës blerëse M.S, të apartamentit me sip. 25 m², me nr. pasurie *** në z.k ***, Pogradec. Vlera e shitjes së apartamentit në shumën 1,152,000 lekë, është likuiduar para redaktimit të kontratës, jashtë zyrës noteriale;
- deklaratë noteriale nr. *** rep., datë 17.8.2010, nënshkruar nga deklaruesi A.B, i cili deklaron se në datën 17.8.2010, i është paguar shuma prej 2,000,000 lekësh nga shtetasja Elveta Murra, për llogari të blerjes së apartamentit me sip. 59.08 m², të ndërtuar nga shoqëria "****" sh.p.k.;
- deklaratë noteriale nr. *** rep., datë 31.3.2011, nënshkruar nga deklaruesi A.B, i cili deklaron se i është paguar shuma prej 200,000 lekësh nga shtetasja Elveta Murra, për llogari të blerjes së apartamentit me sip. 59.08 m², të ndërtuar nga shoqëria "****" sh.p.k.;
- për të vërtetuar faktin e përfitimit të të ardhurave nga shitja e automjetit tip "****", subjekti vë në dispozicion kërkesën nr. *** prot. datë 26.1.2017, nga Elveta Murra drejtuar DRTRSh-së Durrës, për pajisjen me dokumente ligjore të automjetit tip "****", me targa ***, në emër të shtetasës D.O, i cili ka dalë jashtë përdorimi në vitin 2012. Ky automjet ka qenë në emër të shtetasës Elveta Murra, me targa ***.

2.4 ASHK-ja, Drejtoria Vendore Pogradec nuk konfirmon pasuri të paluajtshme të regjistruara në emër të subjektit dhe personave të lidhur me të.

2.5 Referuar deklaratave të interesave private ndër vite, konstatohet se, në DPV-në e vitit 2004, subjekti deklaron pasurinë garsoniere me sipërfaqe 46 m², ndërtuar në vitin 2004 në Lagjen nr.***, Pogradec, e pahipotekuar, me vlerë 120,000 lekë. Nuk deklarohet burimi.

2.6 Në DPV-në e vitit 2005, subjekti rideklaron garsoniere me sip. 46 m², me vlerë 120,000 lekë. Nuk deklarohet burimi.

2.7 Në DPV-në e vitit 2007, subjekti deklaron garsoniere 25 m² të ndërtuar në vitin 2004, në Lagjen nr. ***, Pogradec, vlera e së cilës nuk është 120,000 lekë, por 1,200,000 lekë dhe burimi i blerjes janë të ardhurat e bashkëshortit emigrant në Itali, në vlerën 15,000 euro.

2.8 Në DPV-në e vitit 2010, subjekti deklaron shitjen e apartamentit në Pogradec, në shumën 700.000 lekë dhe blerje të një apartamenti 1+1, me sip. 60 m², në Pogradec, në shumën 2,000,000 lekë. Në këtë DPV, subjekti nuk deklaron detyrimin e pashlyer ndaj palës shitëse në shumën 200,000 lekë. Kjo shumë është deklaruar në DPV-në e vitit 2011, si pagesë për të njëjtin apartament.

2.9 Kjo pasuri rezultoi se është blerë me kontratën nr. ***, datë 20.12.2006 dhe kontratën nr. ***, datë 20.3.2007. Pra, rezultuan 2 kontrata të ndryshme shitblerje për këtë pasuri në vlerën 700,000 lekë.

2.10 Nga hetimi, për apartamentin në Pogradec me sip. 25 m² (pasuri që sipas deklarimit ka shërbyer për blerjen e pasurisë apartament me sip. 60 m²), u konstatua se:

- a) është deklaruar si pasuri e përfituar në vitin 2004, në vlerën 120,000 lekë. Për këtë deklaram nuk rezultoi ndonjë dokument provues;
- b) pasuria është blerë në vitin 2006-2007, me vlerën 700,000 lekë;
- c) në DPV-të për vitet 2004 dhe 2005, sipërfaqja e pasurisë është deklaruar 46 m²;

- d) në DPV-në e vitit 2007, sipërfaqja është deklaruar 25 m², e cila përputhet me sipërfaqen e përcaktuar në kontratë;
- e) në DPV-të periodike për vitet 2004 dhe 2007 janë deklaruar vlera të ndryshme për blerjen e kësaj pasurie.

2.11 Subjekti ka bërë deklarime kontradiktore lidhur me sipërfaqen, vlerën dhe periudhën e pagesës së pasurisë apartament (garsoniere) me sip. 25 m², në Pogradec.

- Bazuar në kontratat e datave 20.12.2006 dhe 20.3.2007, vlera e blerjes së kësaj pasurie është 700,000 lekë. Ndërkohë në DPV-në e vitit 2006, dorëzuar më 4.3.2007, subjekti deklaroi se *vlera e garsonierës së ndërtuar në vitin 2004 nuk është 120,000 lekë por 1,200,000 lekë.*
- Referuar kësaj, në analizën financiare, Komisioni vlerësoi këtë pasuri me vlerën 700,000 lekë, sipas kontratës së shitjes.

2.12 Në DPV-në e vitit 2010 nuk është deklaruar burimi i krijimit të apartamentit me sip. 60 m². Sipas deklaratës *Vetting* janë deklaruar: të ardhura nga shitja e garsonierës me sip. 25 m²; të ardhura nga puna e bashkëshortit si avokat; kursime të akumuluar; kthimi i huas nga një shtetase (F.Zh); si dhe shitja e automjetit tip “****”.

2.13 Për të sqaruar më tepër për këtë pasuri, subjekti u pyet⁶ dhe, në përgjigje të pyetësorit⁷, ka deklaruar se: *“Për garsonierën me sipërfaqe prej 59.08 m² nuk disponoj kontratë shitblerje dhe dokumente pronësie si certifikatë pronësie dhe kartelë shoqëruese. Shtetasi A.K.B kishte përfituar si pronar i tokës edhe këtë garsoniere, të cilën e kam blerë me dy këste. Këstin e parë në shumën 2,000,000 lekë e kam paguar sipas deklaratës noteriale, nr. ***, datë 17.8.2010 dhe kësti i dytë në shumën 200,000 lekë është paguar më 31.3.2011”.*

Ndërsa në lidhje me burimin dhe vlerat që kanë shërbyer për blerjen e këtij apartamenti, subjekti deklaroi se: *“Vlera 2,000,000 lekë, paguar në datën 17.8.2010 ka si burim krijimi shitjen e garsonierës me sip. 25 m², në vlerën 1,152,000 lekë dhe nga pakësimi i gjendjes cash deklaruar në fund të vitit 2009. Vlera 200,000 lekë, paguar në datën 31.3.2011 ka si burim krijimi pakësimin e gjendjes cash në fund të vitit 2010 dhe të ardhurat e realizuara gjatë periudhës së vitit 2010 deri në momentin e pagesës”.*

Për të provuar me dokumentacion blerjen e pasurisë në Pogradec në vitin 2010, vlerën e blerjes dhe burimet e krijimit, subjekti vë në dispozicion dy deklaratat noteriale për pagesat e kryera si dhe deklaratën noteriale për shfuqizimin e marrëveshjes së lidhur duke i kthyer palët në gjendjen fillestare⁸.

Për lidhjen me shtetasen F.Zh dhe vlerat financiare nga kjo shtetase, subjekti ka deklaruar se: *“Me shtetasen F.Zh kam pasur një marrëdhënie dhënie huaje. Kam dhënë hua shumën 500,000 lekë për shkak të nevojave të saj dhe më premtoi që do më jepte edhe interesin 10% për këtë hua. Nuk kisha ndërmend ta merrja këtë interes, për shkak edhe të vështirësive ekonomike që kishte vetë shtetasja F.Zh. Kjo shumë është dhënë në vitin 2006. Në vitin 2008 kam marrë principalin prej 252,000 lekë. Kjo është shuma e vetme që kam marrë prej kësaj shtetaseje, pasi në vitin 2010 ndërroi jetë”.*

Ndërsa në lidhje me të ardhurat e përfituara nga shtetasja D.O, subjekti ka deklaruar se: *“Me shtetasen D.O kam lidhje shoqërore. Në vitin 2006 i kam shitur kundrejt vlerës 300,000 lekë automjetin tip ‘***’, që kisha blerë në vitin 2003”.*

⁶Shihni pyetësorin nr. 2.

⁷Shihni përgjigjen e pyetësorit nr. 2.

⁸Këtë deklaratë e citon, por nuk e ka sjellë bashkëlidhur dokumentacionin në përgjigje të pyetësorit 2.

Për faktin, nëse subjekti i rivlerësimit është gjendur në situatë konflikti interesi, me palë, shoqërinë “***” sh.p.k., apo ortakët dhe administratorët e saj, personin A.B, personin F.H dhe personin F.Zh, subjekti ka sjellë një shkresë⁹ me lëndë, *kthim përgjigje*, të lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, ku pas verifikimeve rezulton se *nuk është regjistruar ndonjë material kallëzues apo procedim penal në emër të shtetasve të sipërcituar*.

2.14 Në këtë përgjigje të pyetësorit, subjekti ndryshon burimin lidhur me blerjen e kësaj pasurie në raport me deklaratën *Vetting*, pasi ka deklaruar se burim për blerjen e saj është edhe nga pakësimi i gjendjes *cash* të vitit 2009. Në DPV-në e vitit 2009, subjekti ka deklaruar gjendje *cash* shumë prej 5,500,000 lekësh, me burim të ardhurat nga shitja e apartamentit në lagjen “***” dhe nga shitja e tokës vresht.

Burimi i krijimit

2.15 Analizimi i burimit të blerjes së apartamentit me sip. 60 m², në Pogradec, bazuar në deklaratën *Vetting*.

- Për sa i përket burimit të krijimit të pasurisë apartament me sip. 60 m², nga të ardhurat nga shitja e garsonierës me sip. 25 m², në Pogradec, në vlerën 1,152,000 lekë, Komisioni vlerëson që këto të ardhura nuk konsiderohen si burim i ligjshëm. Apartamenti me sip. 25 m² është deklaruar nga subjekti, si i blerë me të ardhura nga emigracioni i bashkëshortit, të cilat nuk vërtetohen. Në analizën financiare të mundësisë së blerjes së apartamentit me sip. 60 m², nuk janë përfshirë të ardhurat nga shitja e pasurisë garsoniere me sip. 25 m².
- Për sa i përket burimit të deklaruar si “*të ardhura nga puna e bashkëshortit si avokat, kursimet e akumuluar, ndër vite, nga të ardhurat nga pagat e saj dhe të bashkëshortit si avokat*”, Komisioni konstaton, që të ardhura të akumuluar, ndër vite, nga pagat e subjektit apo bashkëshortit nuk mund të jenë të përfshira te kursimet *cash*, sipas sqarimit të dhënë në pikën 2.14. Ndërkohë, të ardhurat *neto* nga avokatia nga bashkëshorti i subjektit për vitin 2010, në total janë në vlerën 1,520,000 lekë. Për periudhën 1.1.2008 – 17.8.2008, vlera e të ardhurave llogaritet në shumë 950,000 lekë, pa zbritur shpenzimet e jetesës.
- Për sa i përket burimit të deklaruar si “*të ardhura nga kthimi i një pjese të detyrimit nga shtetasja F.Zh*” dhe “*të ardhura të përfituara nga shitja e automjetit tip ‘***’, me targa ***, shtetas D.O*”, Komisioni konstaton, që të ardhurat e akumuluar, ndër vite, nga këto burime, nuk mund të jenë të përfshira te kursimet *cash*, sipas sqarimit të dhënë në pikën 2.14 dhe, si rrjedhim, nuk konsiderohen si burime të ligjshme në analizën financiare të mundësisë së blerjes së apartamentit me sip. 60 m², në Pogradec.

2.16 Analiza financiare

Nga të gjithë burimet e deklaruara nga subjekti në deklaratën *Vetting*, vetëm të ardhurat nga aktiviteti i bashkëshortit si avokat dhe ato nga pagat e subjektit, mund të konsiderohen si burime të ligjshme për pagesën e këstit në vlerën 2,000,000 lekë, për blerjen e apartamentit me sip. 60 m², në Pogradec, në vitin 2010. Këto të ardhura në total kapin vlerën 521,357 lekë, nga pagat e subjektit dhe vlerën 950,000 lekë nga aktiviteti privat i bashkëshortit. Vlera totale e këtyre të ardhurave arrin në shumë 1,471,357 lekë, pa zbritur shpenzimet e jetesës. Qartësisht, duket se subjekti dhe bashkëshorti nuk kishin burime të mjaftueshme për pagesën e këstit në vlerën 2,000,000 lekë, në vitin 2010.

Nga analiza financiare nuk vërtetohet burimi i ligjshëm i blerjes së apartamentit me sip. 60 m², në Pogradec.

⁹Shihni shkresën, datë 8.11.2021, sjellë si dokument provues me përgjigjen e pyetësorit nr. 2.

2.17 Në përfundim të hetimit, Komisioni doli me konkluzionet, për të cilat i kaloi barrën e provës subjektit të rivlerësimit si vijon:

- a) Në DPV-në e vitit 2010, subjekti nuk ka deklaruar burimin e blerjes së pasurisë apartament me sip. 60 m², në Pogradec.
- b) Rezultoi se veprimet për përfitim të kësaj pasurie janë bërë përmes deklaratave noteriale dhe jo me kontratë, sipas dispozitave të Kodit Civil.
- c) Subjekti ka bërë deklarime kontradiktore lidhur me vlerën, sipërfaqen dhe periudhën e pagesës për blerjen e garsonierës me sip. 25 m², që është pretenduar si burim për blerjen e apartamentit me sip. 60 m², në Pogradec. Në DPV-të e viteve 2004 dhe 2005 është deklaruar vlera 120,000 lekë dhe në DPV-në e vitit 2007, vlera 1,200,000 lekë. Pra, janë deklaruar vlera të ndryshme për blerjen e kësaj pasurie. Këto vlera nuk përkojnë me vlerën e përcaktuar në kontratën e shitblerjes, që është vlera 700,000 lekë. Subjekti ka kryer veprime fiktive për caktimin e vlerës në kontratën e blerjes së kësaj pasurie.
- d) Subjekti nuk shpjegoi diferencën e vlerës prej 1,200,000 lekësh, të deklaruar në DPV-në e vitit 2007 për blerjen e pasurisë garsonierë me sip. 25 m², me vlerën e kontratës prej 700,000 lekësh.
- e) Subjekti dhe bashkëshorti i saj nuk vërtetojnë burimin e ligjshëm të blerjes së apartamentit me sip. 60 m², në Pogradec, ku rezultuan me burime të pamjaftueshme për pagesën e këstit prej 2,000,000 lekësh, në vitin 2010.

2.18 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit iu la barrë prove për të dhënë argumente dhe paraqitur prova për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

2.19 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti deklaroi se: *“Për apartamentin me sip. 59.78 m², Pogradec, me vetëm kontratë prenotimi (aktmarrëveshje) datë 17.8.2010, me pronarin e truallit A.B, aktmarrëveshje e revokuar me deklaratë noteriale datë 30.1.2020. Shumat e parapaguara janë të kthyera në vitin 2020. Në datën 17.8.2010 parapaguar shuma 2,000,000 lekë dhe në vitin 2011 parapaguar shuma 200,000 lekë. Burimi i të ardhurave: të ardhura nga përdorimi i gjendjes mjete monetare në fillim të vitit 2010, vlera 3,939,890 lekë. Të ardhura nga shitja në vitin 2010 e garsonierës me sip. 25 m², Pogradec, në shumën 1,152,000 lekë. Në vitin 2011, të ardhura nga përdorimi i gjendjes likuiditete tepricë në fillim të vitit 1,026,484 lekë.*

Pas analizës financiare të bërë nga ana ime mendoj se mundësia financiare për blerjen e apartamentit me sip. 59.78 m², në Pogradec, është e mjaftueshme. Subjekti sjell tabelë të analizës financiare të mundësisë së blerjes apartament në Pogradec.

Garsoniere me sip. 25 m², Pogradec - 2006, paguar me kontratë sipërmarrjeje, shitës F.H, paguar në vitin 2004, 700,000 lekë. Burimi i të ardhurave: kjo pasuri është blerë me të ardhurat e bashkëshortit I.M nga puna në emigracion në Itali, vitet 1996 - 2007, por ne nuk disponojmë dokument legal për të ardhurat në emigracion”.

2.20 Përfaqësuesi i subjektit të rivlerësimit, në seancën dëgjimore, mbajti të njëjtin qëndrim me parashtrimet e paraqitura më 31.3.2022 dhe me ato të paraqitura në rrugë zyrtare më 27.4.2022, të cilat i ridepozitoi përsëri bashkë me dokumentet¹⁰, për të cilat kërkoi që Komisioni t'i konsideronte përpara vendimmarrjes së tij. Por, lidhur me burimin e subjektit krahas burimit të

¹⁰Bashkëlidhur parashtrimeve subjekti ka sjellë dokumentet: aktekspertimin kontabël; aktekspertimin në lidhje me të ardhurat nga sip. prej 2100 m² deri në vitin 2009; shkresa të shtetit gjerman lidhur me qëndrimin në azil të djalit; kontratë shitje nr. ***, datë 8.8.2006; vendime emërimi të subjektit; tabela për shpenzimet dhe deklarime lidhur me personat e lidhur.

deklaruar më parë për blerjen e garsonierës me sip. 25 m², Pogradec, nga të ardhurat e bashkëshortit I.M nga puna në emigracion në Itali, deklaroi si burim blerje të garsonierës edhe të ardhurat e shitjes së automjetit tip “****” shtetases D.O në vlerën e 250,000 lekëve. Subjekti sjell kontratën e shitjes së pasurisë së paluajtshme datë 8.8.2006. Në fund, subjekti citon: “Pas analizës financiare të bërë nga ana ime mendoj se mundësia financiare për blerjen e apartamentit me sip. 59.78 m², në Pogradec, është e mjaftueshme¹¹”.

Vlerësimi i Komisionit

2.21 Komisioni konsideroi si burime për blerjen e apartamentit me sip. 60 m², në Pogradec, të ardhurat nga pagat e subjektit dhe nga aktiviteti i bashkëshortit si avokat.

2.22 Subjekti dhe bashkëshorti nuk vërtetojnë burimin e ligjshëm të blerjes së apartamentit me sip. 60 m², në Pogradec, ku rezultuan me burime të pamjaftueshme për pagesën e këstit prej 2,000,000 lekësh në vitin 2010.

2.23 Në parashtrimet e datës 27.4.2022, subjekti, krahas burimit të deklaruar më parë për blerjen e garsonierës me sip. 25 m², Pogradec (nga të ardhurat e bashkëshortit I.M nga puna në emigracion në Itali, vitet 1996 - 2007, por që nuk disponohet dokument legal për këto të ardhura), deklaroi si burim blerje edhe të ardhurat e shitjes së automjetit tip “****” shtetases D.O, në vlerën 250.000 lekë. Subjekti sjell kontratën e shitjes së pasurisë së paluajtshme datë 8.8.2006. Pra, subjekti ndryshoi deklarinimin në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë apartament me sip. 25 m², në Pogradec, e cila ka shërbyer si burim për blerjen e apartamentit me sip. 60 m², në Pogradec.

2.24 Subjekti nuk arriti të provonte me dokumentacion të ardhurat nga emigracioni, të cilat kanë shërbyer për blerjen e garsonierës me sip. 25 m², në vitin 2004.

2.25 Subjekti dhe bashkëshorti nuk vërtetojnë burimin e ligjshëm të blerjes së apartamentit me sip. 60 m², në Pogradec, ku rezultuan me burime të pamjaftueshme për pagesën e këstit prej 2,000,000 lekësh, në vitin 2010.

2.26 Në përfundim, Komisioni vlerësoi se subjekti ka bërë deklarinim të pasaktë, të pamjaftueshëm dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e pasurisë apartament me sip. 60 m², në Pogradec, në vlerën 2,200,000 lekë, duke u gjendur në kushtet e përcaktuara në geramat “a” dhe “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

3. Automjet tip “**”**

3.1 Subjekti, në deklaratën *Vetting*, ka deklaruar *automjet me targa ***, blerë në shtetin gjerman, në vlerën 13,000 euro dhe për zhdoganimi në vlerën e 526,700 lekë.*

3.2 Burimi i krijimit: shitur automjeti tip “****”, me targa ***, blerë në datën 8.3.2011, në shumën 200,000 lekë, sipas kontratës së shitblerjes nr. ***, nga të ardhurat e përbashkëta familjare. Ky automjet, i cili më pas u targua me targat ***, i është shitur shtetasit A.M në vlerën 450.000 lekë, sipas kontratës së shitblerjes nr. ***, “shitur automjeti i markës ‘****’ me targa *** sipas kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 16.7.2014, ‘****’ sh.p.k., në vlerën e 900,000 lekëve”. Ky automjet i është blerë shtetasit M.S (xhaxhai i subjektit) në vlerën 1,500 euro. Automjeti ka qenë në gjendje shume të mirë dhe shitja e tij ka një vlerë simbolike, pasi është konsideruar më shumë si dhuratë.

3.3 Subjekti, në DPV-në e vitit 2014, ka deklaruar *blerë nga I.M automjet “****”, me datë 18.12.2014 në shtetin gjerman, në vlerën 13,000 euro, paguar vlerë zhdoganimi 526,700 lekë.* Nuk është deklaruar burimi i krijimit të kësaj pasurie.

¹¹Pjesë të parashtrimeve, subjekti sjell edhe një tabelë ku trajton mundësinë e blerjes së automjetit.

3.4 Për të provuar deklarinimin e bërë, subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

- a) kontratë shitblerjeje, nënshkruar në dhjetor të vitit 2014 ndërmjet palës shitëse S.W dhe palës blerëse I.M, të automjetit tip “****”, në vlerën 13,000 euro;
- b) deklaratë e zhdoganimit të automjetit, datë 23.12.2014, për të cilën janë paguar detyrime doganore në shumën 526,532 lekë;
- c) kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 8.3.2001, nënshkruar ndërmjet palës shitëse P.M dhe palës blerëse I.M, të një automjeti tip “****”, vit prodhimi 1989, me nr. shasje ***, kundrejt shumës 200,000 lekë, e cila është likuiduar jashtë zyrës noteriale. Bashkëlidhur vërtetim/deklarim zhdoganimi i automjetit, datë 26.2.1999, si dhe kontrata e blerjes së automjetit, datë 27.3.1999, nga shtetasi P.M në shumën 4,000 USD;
- d) kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 12.10.2012, nënshkruar ndërmjet palës shitëse I.M dhe palës blerëse A.M, të një automjeti tip “****”, me nr. shasje ***, kundrejt shumës 450,000 lekë, e cila është likuiduar jashtë zyrës noteriale;
- e) deklaratë personale për shitje automjeti të peregjistruar në ndonjë shoqëri, nënshkruar në datën 17.9.2012 nga shtetasi M.S, i cili deklaroi se i ka shitur shtetasit I.M automjetin tip “****”, vit prodhimi 2002, me nr. shasje ***, në vlerën 1,500 euro (dokumenti i përkthyer në shqip nga gjuha italiane). Bashkëlidhur deklarata e zhdoganimit të automjetit datë 3.10.2012. Vlera e detyrimeve doganore të paguara në shumën 45,756 lekë;
- f) kontratë shitjeje automjeti nr. ***, datë 16.7.2014, nënshkruar ndërmjet palës shitëse I. M dhe palës blerëse shoqëria “****” sh.p.k., të automjetit tip “****”, me nr. shasje ***, në shumën 900,000 lekë, e cila është likuiduar jashtë zyrës noteriale. Bashkëlidhur faturë tatimore shitjeje nr. 5, datë 5.8.2014, me palë shitëse shoqëria “****” sh.p.k. dhe palë blerëse komuna ***, Elbasan, të automjetit tip “****”, me nr. shasje ***, kundrejt shumës 1,197,600 lekë.

3.5 DPSHTRR-ja, me shkresat nr. *** prot., datë 25.7.2017, datë 7.8.2017 dhe datë 23.10.2017 konfirmon se shtetasi I.M ka në pronësi automjetin me targa **. Bashkëlidhur ndodhet kontrata e shitblerjes, nënshkruar në dhjetor të vitit 2014 ndërmjet palës shitëse S.W dhe palës blerëse I.M, të automjetit tip “****”, në vlerën 13.000 euro.

3.6 Komisioni evidentoi blerjen e lirë dhe shitjen e shtrenjtë të automjeteve edhe pas disa viteve përdorim nga bashkëshorti i subjektit, konkretisht:

- a) automjeti tip “****”, me numër shasje ***, është blerë në datën 8.3.2001 në shumën 200,000 lekë dhe shitur në datën 12.10.2012 në shumën 450,000 lekë;
- b) automjeti tip “****” me numër shasje ***, është blerë në datën 17.9.2012, në shumën 1,500 euro dhe shitur në datën 16.7.2014 në shumën 900,000 lekë.

3.7 Komisioni e ka pyetur¹² subjektin e rivlerësimit në lidhje me pasuritë e luajtshme (automjete) të blera ndër vite prej saj, e cila ka deklaruar¹³ se: *“Nuk është paguar detyrimi për tatimin në burim. Është krijuar së fundmi praktika për pagesën e detyrimeve tatimore për të ardhurat nga fitimi i realizuar nga shitja e automjetit. Pavarësisht se qëndrimi i trajtimit i kësaj të ardhure është për ta deklaruar si të ardhura të tjera, vlerësoj se, pagesa e tatimit duke e trajtuar në zërin ‘të ardhura të tjera’ është jo e saktë. Përcaktimi i të ardhurave të tjera bëhet me ligj. Në frymën e parashikimit të nenit 155 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, tek i cili përcaktohet se: ‘Taksat, tatimet dhe detyrimet financiare kombëtare e vendore, lehtësimi ose përjashtimi prej tyre i kategorive të caktuara të pageseve, si dhe mënyra e mbledhjes së tyre, caktohen me ligj’, potencon argumentin/interpretimin se në kushtet e paparashikueshmërisë së detyrimit në mënyrë eksplicite dhe të qartë, taksapaguesit nuk mund të*

¹²Shihni pyetjet në pyetësorin nr. 2.

¹³Shihni përgjigjet në pyetësorin nr. 2.

ngarkohen me këtë detyrim dhe as të ndëshkohen disiplinarisht sepse nuk kanë supozuar/nënkuptuar apo zgjedhur si opsion pagimin vullnetar të këtij ‘detyrimi’”.

Ndërsa, në lidhje me faktin se përse automjeti tip “****”, blerë në datën 17.9.2012 në shumën 1,500 euro është shitur në datën 16.7.2014 në shumën 1,197,600 lekë dhe a është paguar tatimi mbi fitimin për këtë pasuri, subjekti ka deklaruar se: “Këtë automjet ma ka dhënë xhaxhai im në shumën 1,500 euro. Ka qenë dhuratë nga xhaxhai im, por çmimi simbolik prej 1,500 euro i dhënë për blerjen e këtij automjeti është pas këmbënguljes time për t’i dhënë diçka në këmbim për këtë automjet. Ndërsa qëndrimi im për pagesën e tatimit mbi të ardhurat është ai i sqaruar në pikën më lart”.

Subjekti, krahas provave të tjera, bashkëlidhur përgjigjes së pyetësorit nr. 2, ka vënë në dispozicion kontratën dhe procedurën e zhdoganimit të automjetit tip “****” në vitin 2014 në vlerën 13,000 euro. Burimi i krijimit është nga shitja e automjetit të parë dhe të ardhurat e realizuara nga pagat e vitit 2014.

Gjithashtu, për të provuar mungesën e konfliktit të interesit me palët shitëse dhe blerëse të automjeteve të mësipërme, subjekti solli vërtetimet e lëshuara nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

3.8 Analiza financiare e blerjes së automjetit tip “****”, në vitin 2014

Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* si burim për blerjen e kësaj pasurie të ardhurat nga shitja e automjetit tip “****” në vitin 2012, në vlerën 450,000 lekë dhe automjetit tjetër tip “****” në vitin 2014, në vlerën 900,000 lekë.

Meqenëse subjekti nuk vërteton pagesën e tatimit mbi fitimin kapital të realizuar nga shitja më shtrenjtë e automjeteve, në analizën financiare, të ardhurat nga shitja e tyre janë të barabarta me vetë çmimin e blerjes.

Analiza e mundësisë së blerjes së automjetit *** – 2014

PËRSHKRIMI	VLERA
Të ardhura nga shitja e automjetit tip “****”, me targa ***, viti 2012	200,000
Të ardhura nga shitja e automjetit tip “****”, me targa ***, viti 2014	273,868
Të ardhura totale	473,868
Blerje automjeti tip “****”, me targa ***, viti 2014	2,347,832
Pamundësi blerje automjeti	- 1,873,964

Nga analiza financiare, subjekti dhe bashkëshorti nuk kishin mundësi financiare për blerjen e këtij automjeti, referuar burimit të deklaruar në deklaratën *Vetting*.

Edhe nëse do të merrej i mirëqenë deklarimi i subjektit lidhur me këto burime, pavarësisht se për këto të ardhura nuk janë paguar detyrimet tatimore për fitimin kapital, sërish do të rezultonte pamjaftueshmëri financiare për blerjen e automjetit tip “****” në vlerën -997,832 lekë (450,000 + 900,000 - 2,347,832 = - 997,832 lekë).

3.9 Në përfundim të hetimit lidhur me këto pasuri të luajtshme, Komisioni doli me konkluzione, për të cilat i kaloi barrën e provës subjektit të rivlerësimit, si vijon:

- Subjekti ka bërë veprime fiktive në blerjen e automjeteve me vlera më të ulëta sesa shitjen e tyre vite më pas:

- blerë në vlerën 200,000 lekë në vitin 2001, shitur në vlerën 450,000 lekë në vitin 2012;
 - blerë në vlerën 1,500 euro në vitin 2012, shitur në vlerën 900,000 lekë në vitin 2014.
- b) Subjekti nuk ka deklaruar saktë burimin e blerjes së kësaj pasurie në deklaratën *Vetting*. Të ardhurat e deklaruara nga subjekti për blerjen e kësaj pasurie janë në shumën 450,000 lekë + 900,000 lekë. Këto të ardhura, edhe nëse do të llogariten të plota nga Komisioni, nuk mjaftojnë për blerjen e pasurisë automjet në shumën totale prej 2,347,832 lekësh.
- c) Subjekti nuk ka deklaruar burimin e blerjes së kësaj pasurie në DPV-në e vitit 2014.
- d) Subjekti nuk ka burime të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie, duke rezultuar në një pamundësi në vlerën 1,873,964 lekë.

3.10 Për sa më sipër, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të dhënë argumente dhe paraqitur prova për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit

3.11 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka deklaruar se: *“Automjeti tip ‘***’, me targa ‘***’, është blerë në vitin 2014, çmimi i blerjes 13,000 euro + tarifa doganore, kosto totale e blerjes 2,347,832 lekë. Është pasuria e vetme e blerë gjatë këtij viti, me këto të ardhura: të ardhura nga puna 1,234,794 lekë; të ardhura nga puna e bashkëshortit I.M 186,806 lekë; të ardhura nga puna e djalit E.M 501,490 lekë; të ardhura nga shitja e automjetit ‘***’ me targa ‘***’, me kontratë shitjeje nr. ‘***’, datë 16.7.2014, shitës I.M, blerës ‘***’ sh.p.k., çmimi i shitjes 900,000 lekë; takësimi i gjendjes së mjeteve monetare në fillim të vitit 916,414 lekë.*

*Është e vërtetë që automjetet janë blerë më lirë dhe janë shitur më shtrenjtë, por ju bëj me dije se, automjeti ‘***’ është sjellë nga Italia nga xhaxhai im M.S, resident prej vitesh në Itali dhe ai ka dashur të ma linte dhuratë. Vlera prej 150,000 euro është vërtetë simbolike për të mos e marrë falas mjedin. Ndërsa mjete tjetër ‘***’ i është shitur vëllait të bashkëshortit në vlerën 450,000 lekë, pasi në momentin e shitjes vlera e blerjes së automjetit nuk ka qenë më ajo e vitit 2001. Që bashkëshorti im nuk ka menduar ndonjëherë të bëjë pazare dhe të përfitojë në mënyrë të pandershme me këto veprime, mendoj se e tregon fakti i blerjes së automjetit prej tij në Gjermani, i cili ka kapur vlerën blerje + zhdoganim, mbi 23,000,000 lekë të vjetra”.*

Subjekti kërkoi që në analizën financiare të konsiderohen vlerat e shitjes së këtyre dy automjeteve dhe jo ato të blerjes.

Vlerësimi i Komisionit

3.12 Subjekti i rivlerësimit ka ndryshuar deklarimin e saj në lidhje me burimin e blerjes së pasurisë automjet në vlerën 13,000 euro. Ndërsa në deklaratën *Vetting* si burim kanë qenë të ardhurat nga shitja e automjetit tip “****” në vitin 2012 në vlerën 450,000 lekë dhe automjetit tjetër tip “****” në vitin 2014 në vlerën 900,000 lekë. Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti ka shtuar si burim edhe të ardhurat nga puna e saj dhe e bashkëshortit, si dhe gjendjen *cash* të vitit paraardhës.

3.13 Subjekti nuk provoi pagesën e tatimit mbi fitimin kapital të realizuar nga shitja më shtrenjtë e automjeteve dhe, për pasojë, në analizën financiare të ardhurat nga shitja e tyre janë të barabarta me çmimin e blerjes. Rezultoi se subjekti nuk kishte burime të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie, duke rezultuar me një pamundësi në vlerën 1,873,964 lekë.

3.14 Në përfundim, Komisioni vlerësoi se subjekti ka bërë deklaram të pasaktë, të pamjaftueshëm dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e

pasurisë automjet në vlerën 13,000 euro, duke u gjendur kështu në kushtet e përcaktuara në germën “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

4. Likuiditete bankare

4.1 Llogari bankare në shumën 5,533.96 lekë në “Credins Bank”. Pjesa takuese: 100%. Kjo llogari është deklaruar në rubrikën e pasurive të personit të lidhur I. M.

4.2 “Credins Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 14.8.2017, konfirmon llogari page me gjendje 5,666 lekë në emër të znj. Elveta Murra.

4.3 Kjo llogari nuk është deklaruar saktë nga ana e subjektit dhe bashkëshortit.

4.4 Subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* asnjë nga llogaritë e tjera bankare të saj apo të personave të lidhur (bashkëshortit dhe fëmijëve).

4.5 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit i ka kaluar barra e provës për të dhënë argumentet dhe paraqitur provat për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga ana e Komisionit.

4.6 Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti nuk dha shpjegime bindëse për mosdeklarimin e këtyre likuiditeteve bankare.

4.7 Në përfundim, Komisioni i vlerësoi këto mosdeklarime si pasaktësi të subjektit të rivlerësimit në plotësimin e deklaratës *Vetting*.

5. Dhurime nga prindërit e subjektit dhe bashkëshortit

5.1 Në deklaratat periodike vjetore subjekti ka deklaruar të ardhura nga dhuratat për ditëlindje të fëmijëve E dhe K, bërë nga prindërit e saj B dhe Sh.S dhe S.M në shumën 250,000 lekë. Për këtë subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr. ***, datë 5.3.2013, të shtetasit B. S, i cili deklaroi se në datën 1.1.2008 i ka dhuruar për ditëlindje nipit E.M shumën 100,000 lekë dhe në datën 1.1.2009 shumën 50,000 lekë. Gjithashtu, për ditëlindjen e mbesës K.M i ka dhuruar në datën 31.1.2008 shumën prej 100,000 lekësh, e ardhur e përfituar nga shitja e tokës që ka trashëguar nga babai Q.S në Dibër.

5.2 Subjekti i rivlerësimit është pyetur në lidhje me mundësitë financiare të dhuruesve sipas viteve përkatëse të dhurimeve, e cila, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka deklaruar se: “*Ju vendos në dispozicion dokumentacionin dhe vërtetimet e lëshuara nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Elbasan dhe Dibër për të ardhurat nga pensioni i prindërve të mi dhe babait të bashkëshortit*”.

Analiza e mundësisë së dhurimit 250,000 lekë nga shtetasit Sh dhe B.S

Të ardhura nga pensioni B.S	1,975,733
Të ardhura nga pension suplementar B.S	445,501
Të ardhura nga pensioni Sh.S	1,204,804
Të ardhura total, periudha 1991 – 31.1.08	3,626,038
Shpenzime jetese dy persona, periudha 1991 – 31.1.2009	3,072,004
Dhuar subjektit, viti 2005	35,000
Dhuar subjektit, viti 2008	200,000
Dhuar subjektit, data 1.1.2009	50,000
Mundësi kursimi	269,034

Analiza e mundësisë së dhurimit 145,000 lekë nga shtetasi S.M

Të ardhura nga pensioni S.M	1,178,114
Të ardhura totale, periudha 1991 – 31.1.2008	1,178,114
Shpenzime jetese, periudha 1991 – 2008	281,833
Dhuruar subjektit, viti 2005	25,000
Dhuruar subjektit, viti 2007	20,000
Dhuruar subjektit, data 1.1.2009	100,000
Mundësi kursimi	751,281

5.3 Rezultoi se prindërit e subjektit dhe babai i bashkëshortit S.M kanë pasur mundësi financiare për dhurimet e kryera ndër vite fëmijëve të subjektit.

6. Deklarimi i kredisë në vlerën 280,000 lekë, në “Alpha Bank”, nga djali i subjektit E.M, në vitin 2014

6.1 Gjatë hetimit administrativ të bërë nga Komisioni, subjekti është pyetur lidhur me mosdeklarimin e një kredie në vlerën 280,000 lekë në “Alpha Bank”, të marrë nga djali i saj E.M.

6.2 Subjektit i është kërkuar arsyeja e mosdeklarimit, arsyeja marrjes së kredisë dhe paraqitja e një kopjeje të kontratës së kredisë në fjalë.

6.3 Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka deklaruar se: *“Marrja e kredisë nga djali im E.M është pasqyruar në DVP-në e vitit 2014, e shoqëruar me statement të bankës. Por nga ana ime gabimisht është harruar të shoqërohet përgjigjja me kopje të kontratës. Kjo kredi është marrë për nevojat e tij personale (fejesë). Ju paraqes fotokopje të faqes *** të DVP-së së vitit 2014, kontratë huaje 14 fletë”.*

6.4 Pas vlerësimit të përgjigjes së subjektit të rivlerësimit dhe shqyrtimit të provave bashkëlidhur kësaj përgjigjeje, Komisioni konstatoi se subjekti ka sjellë si provë një fotokopje të faqes *** të DVP-së së vitit 2014.

6.5 Referuar dokumentacionit të depozituar nga ILDKPKI-ja të deklaratave periodike vjetore të subjektit të rivlerësimit, faqja 10 e DPV-së së vitit 2014, nuk rezultoi e njëjtë me atë të paraqitur nga subjekti. Konkretisht, tek përshkrimi i detyrimeve të personit të lidhur E.M nuk figuron e deklaruar kredia e marrë në “Alpha Bank” në vlerën 280,000 lekë, ashtu siç e sjell subjekti në provën e paraqitur prej saj.

6.6 Në përfundim të hetimit, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të paraqitur argumente dhe prova për të provuar të kundërtën e konstatimeve, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

6.7 Në përgjigje të rezultateve të hetimit të datës 27.4.2022, në lidhje me këtë dokument të ndryshëm (faqja *** e DPV-së së vitit 2014) me atë të paraqitur nga subjekti në përgjigje të pyetësorit, subjekti ka shpjeguar se: *“Unë kam dorëzuar në ILDKPKI dy deklaratat periodike për vitin 2014. Në deklarimin e parë gabimisht nga ana ime nuk është deklaruar marrja e kredisë nga ana e djalit tim E.M. Për këtë fakt unë kam kaluar në kontroll nga ana e ILDKPKI-së dhe kam dhënë deklarime administrative përpara këtij institucioni në datën 2.3.2016, ku është konstatuar ky fakt dhe bashkë me inspektoren e këtij institucioni është përpiluar një faqe tjetër, dhe konkretisht faqja nr. *** e deklarimit, ku është shënuar/pasqyruar marrja e kredisë nga djali im në ‘Alpha Bank’ në shumën prej 280,000 (dyqind e tetëdhjetë mijë) lekësh. Kur*

*kam dorëzuar përgjigjet e pyetësorit nr. 3 unë kam paraqitur kopjen e faqes nr. *** të DPV-së së vitit 2014, e cila është përpiluar nga ana ime në Inspektorat me të gjitha rregullimet që u bënë. Pra, nuk kam dorëzuar një dokument të rremë ose të falsifikuar. Sqaroj se përpara ILDKPKI-së unë kam dorëzuar edhe statement bankar të 'Alpha Bank' për djalin tim, ku pasqyrohen të gjitha shpenzimet e kryera për shlyerjen e kësaj kredie. Kërkoj nga ana e Komisionit që të administrojë procesverbalin e deklarimeve të mia të datës 2.3.2016 dhe dokumentet e tjera bashkëngjitur, e cila e vërteton këtë fakt. Nuk kam pasur asnjë arsye që të mos e deklaroj apo të ndryshoj këtë deklaram, si unë ashtu, edhe djali im E.M”.*

6.8 Në analizë të kësaj problematike të subjektit, Komisioni mbeti i paqartë në lidhje me këtë shpjegim, duke qenë se kjo e fundit ka sjellë si provë në Komision një dokument të ndryshëm nga ai i depozituar në ILDKPKI prej saj në datën 20.3.2015, duke deklaruar se: *“Faqja nr. *** e DPV-së së vitit 2014 që unë disponoj ka dy faqe, ku njëra është ajo e korigjuar dhe që pasqyron edhe marrjen e kredisë nga djali”.*

6.9 Procesverbali i mbajtur nga ILDKPKI-ja në vitin 2016 me subjektin e rivlerësimit, dokument të cilin subjekti e sjell si provë, nuk provon faktin e depozitimit dy herë të faqes *** të DPV-së së vitit 2014, përkundrazi, aty sqarohet për një fakt (të marrjes kredi në “Alpha Bank” nga djali E. M.), të cilin subjekti duhej ta kishte deklaruar në DPV-në e vitit 2014.

6.10 Në kuptim të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, “Për deklarinin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” procesverbalet janë dokumente sqaruese e plotësuese, por asnjëherë zëvendësuese të DPV-së së plotësuar e dorëzuar brenda afatit ligjor në ILDKPKI. Deklarata e pasurisë është një dokument që dorëzohet vetëm një herë dhe nuk lejohen korigjime. Ky arsyetim hedh poshtë pretendimin e subjektit për depozitim më shumë se një herë të një dokumenti të rëndësishëm siç është deklarata e pasurisë.

6.11 Komisioni, pas analizës së këtij fakti, doli në përfundimin se veprime të tilla të dëshmuara nga subjekti i rivlerësimit Elveta Stafa (Murra) përbëjnë cënim të figurës së prokurores dhe humbasin besimin e publikut në sistemin e drejtësisë.

7. Analiza financiare

SUBJEKTI I RIVLERESIMIT: ELVETA B. MURRA																
PERSHKRIMI	1985 - 2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	TOTAL
PASURI	1,855,803	150,597	1,249,969	956,925	-444,642	-34,477	4,198,498	7,044,810	-1,939,890	-826,484	138,845	-497,423	1,431,418	646,143	422,671	14,352,763
Apartment 65 m2, 2+1, L.****, Elbasan- 1997 - Elveta Murra	1,150,000															1,150,000
Apartment 27 m2 Rr. ****, Elbasan - 1993 - Elveta + I. M.	5,803															5,803
Apartment 60 m2, 1+1, Rr.****, Elbasan - 1996 - Elveta + I.M.	500,000															500,000
Toke 2,100 m2 *** Elbasan nga privatizim nga ndermarrja bujqesore																0
Apartment 25 m2 L.*** Pogradec - 2006 - Elveta Murra			700,000													700,000
Apartment 116 m2 L.****, Elbasan 3+1, - 45,435€ - I. M. - 50% - 2008							4,200,000	1,300,000								5,500,000
Apartment 60 m2 Pogradec - 50%									2,000,000	200,000						2,200,000
Autoveture **** - 2003 - 100%		150,000														150,000
Automjet **** - I. M.- 2001	200,000															200,000
Automjet **** - 2012											273,868					273,868
Automjet **** - 100% - 13,000€ - 2014 - I. M.													2,347,832			2,347,832
Automjet ***** - E. M. - 2015														300,000		300,000
Ndryshim ne likuiditet		597	549,969	956,925	-444,642	-34,477	-1,502	5,744,810	-3,939,890	-1,026,484	-135,023	-497,423	-916,414	346,143	422,671	1,025,260
DETYRIME	0	0	0	0	-500,000	775,196	257,066	-66,033	-79,146	-96,650	-93,847	-152,104	208,368	-281,219	-117,400	-145,770
Kredi Raiffeisen Bank 800,000 leke - 2007 - Elveta dhe I. M.						775,196	-775,196									0
Kredi Raiffeisen Bank 799,987.14 - 2008 - Elveta dhe I.M.							780,261	-66,033	-79,146	-96,650	-93,847	-152,104	-162,550	-129,931		0
Kredi Alpha Bank - 280,000 leke - 2014 - E. M.													248,590	-71,942	-96,216	80,432
Kredi BKT - per rregullim shtepie - 160,000 leke - 2014 - E. M.													122,328	-79,347	-21,184	21,798
Huadhenie shtetases F. Zh. - 2006					-500,000		252,000									-248,000
PASURI NETO (PASURI - DETYRIME)	1,855,803	150,597	1,249,969	956,925	55,358	-809,673	3,941,432	7,110,844	-1,860,743	-729,834	232,691	-345,319	1,223,049	927,363	540,071	14,498,533
TE ARDHURA dokumentuar	3,857,185	490,342	568,890	975,602	1,006,390	925,284	4,212,073	2,947,246	3,581,680	2,457,871	1,415,336	1,232,190	2,196,958	2,015,310	1,543,560	29,425,917
Te ardhura nga puna subjekti Elveta Murra	2,768,654	490,342	568,890	793,062	856,390	885,284	852,073	924,746	909,680	937,871	1,008,552	1,025,406	1,234,794	1,299,182	1,327,550	15,882,476
Te ardhura nga puna bashkeshorti I. M.	538,531	0	0	0	0	0	960,000	1,440,000	1,520,000	1,520,000	206,784	206,784	186,806	213,758	216,010	7,008,673
Te ardhura nga puna djali E. M.		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	501,490	364,720	0	866,210
Te ardhura nga shitja e apartamentit Elbasan 60 m2 - 1997	150,000															150,000
Te ardhura nga shitja e apartamentit 27 m2 Elbasan - 1997	400,000															400,000
Te ardhura nga shitja e automjetit **** - 2006					150,000											150,000
Te ardhura nga shitja e apartamentit 65m2 Elbasan - 2009							2,200,000	432,500								2,632,500
Te ardhura nga shitja e apartamentit 25 m2 Pogradec - 2010									1,152,000							1,152,000
Te ardhura nga dhurime nga familjare per ditelindje				182,540		40,000	200,000	150,000								572,540
Te ardhura nga shitja e automjetit **** - 2012											200,000					200,000
Te ardhura nga shitja e automjetit **** - 2014													273,868			273,868
Te ardhura nga shitja e automjetit **** - 2015														137,650		137,650
SHPENZIME	1,954,124	301,892	301,892	496,352	734,669	1,198,298	3,619,881	1,610,975	1,669,786	786,686	1,617,810	1,113,414	1,988,270	1,376,908	2,286,225	19,103,057
Shpenzime jetese	1,809,624	281,892	281,892	429,098	438,228	546,480	546,480	546,480	546,480	546,480	558,192	564,096	879,992	897,104	940,368	9,812,886
Shpenzime arsimimi E. M.					200,000	525,460	492,730	548,680	277,620							2,044,490
Shpenzime per qira E. M., Tirane							43,114	96,019	48,584							187,716
Shpenzime per rregullim te apartamentit 3+1 Elbasan - 2010									360,000							360,000
Shpenzime per token vreshte 1996 - 2009	140,000	20,000	20,000	20,000	20,000	20,000	20,000	20,000	20,000	20,000	20,000	20,000	20,000	20,000	20,000	280,000
Shpenzime per pushime ne Shqiperi				35,000	35,000	35,000	35,000	35,000	35,000	35,000	35,000	35,000	35,000	35,000	35,000	245,000
Shpenzime per tatim shitje pasuri te paluajtshme	4,500							148,250	45,200							197,950
Shpenzim mobilim apartament 60 m2 ne Pogradec									50,000							50,000
Shpenzime per te cilat jane marre kredi nga E. M. - 2014													575,000			575,000
Shpenzime interesi + kom. kredi E. M.- 280,000 leke - Alpha Bank													20,441	40,058	33,784	94,282
Shpenzime interesi + kom. kredi E.M. - 160,000 leke - BKT													10,665	11,174	6,097	27,936
Shpenzime interesi + kom. kredi Elveta dhe I. M. - 800,000 leke - RFZ						59,267	138,965	137,209	126,795	106,717	81,336	71,037.91	34,426.59	6,683.57		762,437
Shpenzim i vleres se terhequr nga depozita BKT - I. M.- 2008							2,211,755									2,211,755
Shpenzime per sigurim jete per I.M. dhe K.M. - 2016															687,172	687,172
Shpenzime per blerje me karte brenda dhe jashte vendi															112,668	112,668
Shpenzime udhetimi			0	12,254	41,441	12,091	131,837	79,338	180,107	98,489	978,282	478,280	467,746	421,888	506,137	3,407,889
Analiza dokumentuar	47,258	37,853	-982,971	-477,675	216,363	536,659	-3,349,240	-5,774,573	3,772,638	2,401,019	-435,165	464,095	-1,014,361	-288,961	-1,282,736	-6,177,055
																Pamundesia financiare totale
																-13,605,682

- Nga analiza financiare e kryer del se subjekti dhe bashkëshorti kanë një pamundësi financiare në shumën 13,605,682 lekë.

8. Metodologjia e përdorur nga Komisioni për analizën financiare

Gjatë kësaj analize, Komisioni është bazuar në:

a. Gjendjet e likuiditeteve të subjektit dhe personave të lidhur, të nxjerra nga dokumentet bankare të kërkuara nga bankat e nivelit të dytë: ProCredit Bank, BKT, Alpha Bank, Raiffeisen Bank, ABI Bank, Credins Bank, Credins Invest, FiBank, OTP Bank, si dhe gjendjet *cash* të deklaruara nga subjekti. Ndryshimet e gjendjeve të kursimeve *cash* janë konsideruar në analizën financiare sipas deklarimeve të subjektit në deklaratat periodike vjetore¹⁴.

b. Të ardhurat e ligjshme, ku përfshihen:

i) Të ardhurat nga pagat e subjektit si: kryesekretare në Prokurorinë e Rrethit Elbasan (vitet 1985 – 1990); prokurore sektori në Prokurorinë e Rrethit Elbasan (vitet 1990 – 1993); hetuese në Prokurorinë Elbasan (vitet 1993 – 1995); dhe prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan (vitet 1995 – 2016).

ii) Të ardhurat nga bashkëshorti i subjektit në: Repartin Ushtarak ***, Elbasan (vitet 1994 – 1995); Komisaratin e Policisë Sarandë (viti 1999); Elektrik Elbasan sh.a. (vitet 1999 – 2002); si dhe të ardhura nga biznesi privat si avokat (vitet 2008 – 2016).

Subjekti pretendon se Komisioni nuk ka konsideruar të ardhurat e sakta nga aktiviteti privat i bashkëshortit në vitet 2012 – 2013.

Subjekti citon shkresën nr. *** prot., datë 21.7.2017, të Bashkisë Elbasan, të paraqitur në ILDKPKI për të ardhurat nga aktiviteti për periudhën 2008 – 2013. Sipas kësaj shkrese, të ardhurat janë në shumën 2,584,800 lekë për secilin nga vitet 2012 dhe 2013.

Nga ana tjetër, subjekti, në përgjigje të pyetësorit, ka sjellë shkresën nr. *** prot., datë 21.2.2022, e cila vërteton se për vitet 2012 dhe 2013 xhiroja për të cilën janë paguar detyrimet tatimore është përkatësisht në shumën 258,480 lekë për secilin nga këto vite.

Gjithashtu, në prapësime, subjekti ka sjellë shkresën nr. *** prot., datë 29.3.2022, të Bashkisë Elbasan, e cila vërteton se subjekti “I.M” është trajtuar si subjekt me xhiro nën 2,000,000 lekë për efekt të llogaritjes së taksave dhe tarifave vendore për vitet 2012 dhe 2013.

Ndërkohë, në DPV-të e viteve 2012 dhe 2013, subjekti deklaroi të ardhura nga puna e bashkëshortit si avokat, përkatësisht në vlerat 258,480 lekë dhe 440,000 lekë.

Referuar deklaramit të subjektit në DPV-të e viteve 2012 dhe 2013, si dhe dy shkresave të Bashkisë Elbasan që vërtetojnë të ardhura nën 2,000,000 lekë për këto vite, në analizën financiare nuk mund të merret parasysh pretendimi i subjektit për të ardhura më të larta se 2,000,000 lekë.

iii) Të ardhurat nga djali i subjektit në Ujësjellësin ***, Elbasan (vitet 2014 – 2015).

iv) Të ardhurat nga shitja e apartamentit me sip. 60 m² në Elbasan (viti 1997).

v) Të ardhurat nga shitja e apartamentit me sip. 27 m² në Elbasan (viti 1997).

vi) Të ardhurat nga shitja e apartamentit me sip. 65 m² në Elbasan (viti 2009).

vii) Të ardhurat nga shitja e tokës me sip. 2,100 m² në Elbasan (viti 2009) nuk janë përfshirë në analizën financiare (trajtuar në pikën 1 të rezultateve të hetimit). Subjekti nuk vërtetoi pagesën e tatimit mbi të ardhurat nga shitja e kësaj pasurie.

¹⁴Shihni vendimin nr. 31, datë 12.10.2021, të Kolegjit, paragrafi 25.2.

viii) Të ardhurat nga shitja e apartamentit me sip. 25 m² në Pogradec (viti 2010).

ix) Të ardhurat nga shitja e automjetit tip “****” (viti 2006).

x) Të ardhurat nga shitja e automjetit tip “****”, me targa *** (viti 2012).

xi) Të ardhurat nga shitja e automjetit tip “****”, me targa *** (viti 2014).

xii) Të ardhurat nga shitja e automjetit me targa *** (viti 2015).

Të ardhurat nga shitja e automjeteve është sa çmimi i blerjes së këtyre automjeteve, meqenëse subjekti nuk ka vërtetuar pagesën e detyrimit tatimor për fitimin kapital të realizuar kur automjeti është shitur me çmim më të lartë se ai i blerjes. Përjashtim bën këtu automjeti me targa **, i cili është shitur me çmimin 1,000 euro (i barasvlershëm me 137,650 lekë), ndërkohë që u ble me çmimin 300,000 lekë. Të ardhurat nga shitja e këtij automjeti janë sa çmimi i shitjes.

xiii) Të ardhurat nga dhurimet nga shtetasit Sh. e B.S. dhe S.M. (vitet 2005 – 2009)

c. Shpenzimet, ku përfshihen:

i) Shpenzimet e jetesës, bazuar në shpenzimet mujore për konsum sipas përbërjes familjare (anketa e buxhetit të familjes nga INSTAT-i).

ii) Shpenzimet për tokën vreshtë (vitet 1996 – 2009), sipas deklarimeve të subjektit në përgjigje të pyetësorit.

iii) Shpenzimet për pushime në Shqipëri (vitet 2005 – 2011), sipas deklarimeve të subjektit në përgjigje të pyetësorit.

iv) Shpenzimet për tatimin mbi të ardhurat e shitjes së pasurisë së paluajtshme në vitet 1997, 2009 dhe 2010.

v) Shpenzimet e arsimimit të djalit të subjektit E.M. (vitet 2006 – 2010), si dhe shpenzimet e qirasë së tij në Tiranë gjatë periudhës së studimeve (vitet 2008 – 2010).

vi) Shpenzimet për rregullim apartamenti në rrugën “****”, Elbasan (viti 2010), sipas deklarimeve të subjektit në përgjigje të pyetësorit.

vii) Shpenzimet për mobilim të apartamentit me sip. 60 m² në Pogradec (viti 2010), sipas deklarimeve të subjektit në përgjigje të pyetësorit.

viii) Shpenzimet për të cilat janë marrë kredi dhe *overdraft* (viti 2014) nga djali i subjektit E.M. në BKT dhe kredi në “Alpha Bank”.

ix) Shpenzimet e interesit dhe komisionet, si dhe për shlyerje principali për kreditë e marra nga Elveta dhe I.M në “Raiffeisen Bank” (vitet 2007 – 2015), si dhe nga djali E.M në BKT dhe “Alpha Bank” (vitet 2014 – 2016).

x) Shpenzimet për sigurim jete për bashkëshortin I.M. dhe vajzën K.M. (viti 2016).

xi) Shpenzimet për blerje me *master card* brenda dhe jashtë vendi (viti 2016), ku nuk përfshihen shpenzimet për ushqimet.

xii) Shpenzimet e udhëtimit për të cilat janë marrë të dhëna nga sistemi *TIMS*. Për përlllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit është zbatuar vendimi nr. 11/2019 (JR.), datë 22.5.2019, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Nuk janë marrë në konsideratë shpenzimet e udhëtimit kur subjekti/bashkëshorti kanë deklaruar dhe dokumentuar udhëtime për qëllime pune dhe ato për të cilat janë dokumentuar qëndrim pranë njerëzve të afërm.

Në veçanti, subjekti ka deklaruar për një udhëtim të djalit E. M në Gjermani, ku sipas saj ka qëndruar në një kamp azilkërkuesish dhe më pas është kthyer me dëshirë në Shqipëri. Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka sjellë dokumentacion nga kampi i azilkërkuesve “****”, në të cilin vërtetohet se E.M ka qenë banor i kampit “****” për periudhën 20.8.2015 – 17.10.2015. Në bazë të kësaj, Komisioni krijoi bindjen se nuk duhen llogaritur shpenzime qëndrimi për djalin e subjektit në shtetin gjerman gjatë kësaj periudhe.

xiii) Shpenzimet e vlerës së tërhequr nga depozita në BKT nga shtetasi I.M në datën 1.8.2008, sipas *statement*-it të BKT-së.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti pretendon se vlera e hyrë në bankë nga shtetasi B.P në datën 14.5.2008 është parapagim i kontratës nr. ***, datë 5.5.2009, dhe në datën 1.8.2008 është tërhequr shuma 2,211,755 lekë nga shtetasi I.M. Subjekti ka deklaruar në përgjigje të rezultateve se vlerën e marrë nga shitja e apartamentit tek lagjja “****” e ka përdorur në vitin 2009 për pagesën e bërë në këtë vit për blerjen e apartamentit në rrugën “****”, ndërkohë që nuk e ka deklaruar si kursim *cash* në vitin 2009. Prandaj kjo vlerë e tërhequr nuk mund të konsiderohet si burim për pagesën e vitit 2009 dhe është konsideruar si shpenzim për vitin 2008.

ç. Vlerat e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, bazuar në kontratat e sipërmarrjeve/shitblerjeve të këtyre pasurive¹⁵.

d. Huadhënien ndaj shtetasit F. Zh dhe kthimin e një pjese të saj, sipas deklarimit të subjektit.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, në përfundim të hetimit të kryer, në zbatim të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, duke u bazuar në njërin prej kriterëve të vlerësimit, atë të pasurisë, në vlerësimin tërësor të çështjes, mbështetur në provat e administruara nga Komisioni, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit Elveta Murra Stafa, bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, ka kryer deklarim të pasaktë të pasurive dhe të interesave private, nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së saj, si dhe është përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi dhe përdorim.

Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk justifikon me burime të ligjshme krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve përgjatë gjithë periudhës që ka ushtruar funksionin si prokurore.

Mbështetur në konkluzionet e mësipërme, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, në kuptim të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit:

- a) Ka kryer deklarime kontradiktore gjatë procesit administrativ dhe duke mos iu përgjigjur saktë pyetjeve të Komisionit lidhur me pasuritë.
- b) Ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe kryerjen e shpenzimeve për periudhën 2003 – 2016.
- c) Ka bërë deklarim të pasaktë lidhur me pasuritë e krijuara dhe burimin e ligjshëm.

¹⁵Shihni kontratat e shitjeve për pasuritë e paluajtshme në dosjen e ILDKPKI-së.

- d) Ka bërë deklarin të rremë, të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, në kuptim të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.
- e) Nga veprimet dhe qëndrimet e saj ka cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, në kuptim të pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

Kështu që, në rastin e subjektit të rivlerësimit Elveta Murra për kriterin e vlerësimit të pasurisë, vërtetohen shkaqet e parashikuara në nenin D të Aneksit të Kushtetutës, të parashikuara të tilla që të zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të germës “c”, të pikës 1, të nenit 58 dhe të pikave 3 dhe 5, të nenit 61, në lidhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Elveta Stafa (Murra), prokurore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 23.5.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Etleda ÇIFTJA
Kryesuese

Roland ILIA
Relator

Pamela QIRKO
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Amela Idrizi